

Rendi i ditës

Syri i Vizionit,

anëtare e Koalicionit për KOMRA, organizon:

Konsultimet lokale me familjarët e viktimave dhe shoqatat e dala nga lufta nga rajoni i Dukagjinit, mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-s

28.01.2010

Hotel Dukagjini, Pejë

- 10:00 -10:15 **Hapja e takimit: Përse KOMRA?**
Veton Mujaj, Syri i Vizionit
- 10:15 – 10:45 **Informimi i pjesëmarrësve me rrjedhën e procesit konsultativ në vendet e ish Jugosllavisë:**
- a) Qëllimet e procesit konsultativ**
b) Mendimet e thëna, propozimet dhe rekomandimet mbi elementet dhe aktivitetet e KOMRA-s:
Faktet dhe shkaqet e luftës
Mandati i komisionit për të vërtetën
Qëndrimi ndaj gjykatave për krime lufte
Regjistrimi i viktimave dhe humbjeve në njerëz
Kriteret për zgjedhjen dhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të komisionit
Struktura e komisionit
Dëgjimi publik i viktimave
Qëndrimi ndaj kryerësve të krimeve
Pajtimi
- Bekim Blakaj, Fondi për të drejtën humanitare, Kosovë**
- 10:45 – 11:10 **Përvojat e mira e të tjerëve në verifikimin e fakteve për të kaluarën**
Qëllimet e komisioneve për të vërtetën: Faktet dhe shkaqet e luftës
Mandati i komisionit për të vërtetën
Regjistrimi i viktimave dhe i humbjeve në njerëz
Qëndrimi ndaj gjykatave për krime lufte

Kriteret për zgjedhjen dhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të komisionit
 Struktura e komisionit
 Dëgjimi publik i viktimave
 Qëndrimi ndaj kryerësve të krimeve
 Pajtimi

Nora Ahmetaj, anëtare e Koalicionit për KOMRA

11:10 – 11:25	Filmi dokumentar mbi iniciativën për KOMRA
11:25 – 12:00	Pauza
12:00 – 15:00	Diskutimi Besarta Vasija , Fondi për të drejtën humanitare, Kosovë
15:00	Fjalët përmbyllëse

Veton Mujaj: Ju falënderoj për mundësinë që keni gjetur për të ardhur këtu. Është një kohë pak e ftoftë dhe nuk ka qenë shumë lehtë të vini prej atyre vendeve, por gjithsesi ju falënderoj për pjesëmarrje edhe një herë.

Unë jam Veton Mujaj, nga Syri i Vizionit, Pejë dhe një prej anëtarëve të Koalicionit për KOMRA. Fillimisht desha ti prezantoj ata që janë me mua sot, në një pjesë të diskutimit të parë: është Nora Ahmetaj, anëtare e Koalicionit për KOMRA dhe Bekim Blakaj, nga Fondi për të Drejtën Humanitare të Kosovës dhe Besarta Vasija, që do të jetë moderatore në pjesën tjetër të takimit.

Kisha pasur dëshirë që fillimisht të shkojmë njëri pas tjetrit të prezantohemi me radhë. Prej kësaj radhe, dhe besoj se mundeni përmes këtij dhe kisha pasur dëshirë të prezantoheni me emër e mbiemër, çka përfaqësoni dhe prej cilit vend, cilit fshat, cilës komunë vini.

Nora Ahmetaj: Unë jam Nora Ahmetaj, jam një kohë të gjatë aktiviste për të drejtat e njeriut në Kosovë por edhe në rajon. Tash jam anëtare e Koalicionit për KOMRA prej vitit 2008, Prishtinë.

Tahir Miranaj: Jam Tahir Miranaj, invalid i luftës, vij nga komuna e Istogut. Përfaqësoj shoqatat e dala nga lufta.

Tahir Rraci: Jam Tahir Rraci, nga fshati Luginavexhi, komuna e Pejës, ish i burgosur politik në Burgun e Dubravës.

Milaim Çekaj: Jam Milaim Çekaj, nga komuna e Deçanit, njëkohësisht jam përjetues i masakrës së Dubravës.

Daut Elshani: Jam Daut Elshani, nga fshati Staradran, babë i tre dëshmorëve, megjithë se këtu shkruan “civil” dhe shumë gabim kanë bërë që e kanë shkruar dhe nuk janë në këtë listë djemtë e mi. Tre djemtë i kam dëshmorë! Ju falënderoj që i keni shkruar, e ku i

keni marrë këto, pyetni pak më lartë, se më keni lënë shumë të brengosur me ditën e sotme.

Adem Fetahu: Quhem Adem Fetahu, jam nga komuna e Istogut, jam i zënë në luftë dhe jam ish i burgosur i luftës.

Idriz Fetahi: Jam Idriz Fetahi, nga fshati Padalishtë, komuna e Istogut, ish i burgosur i 2009-ës, domethënë fillimi i 2009-ës deri në mbarim.

Isa Gashi: Jam Isa Gashi, nga fshati Pavlan, si kryeplak i fshatit dhe i kam dy martirë, Zymer Sadik Gashin dhe Ajshe Kelmendin.

Nezir Kastrati: Jam Nezir Kastrati, nga Zahaçi, i kam të vrarë dy dëshmorë.

Emine Bytyqi: Jam Emine Bytyqi, vij nga Peja, përkatësisht fshati Rashiq. I kemi 18 të pagjetur, e kam motrën dhe vëllain të pagjetur.

Fatime Gjocaj: Jam Fatime Gjocaj, vij nga fshati Rashiq, jam motra e vëllait dhe e motrës së zhdukur.

Sahit Gjocaj: Quhem Sahit Gjocaj, vij nga fshati Rashiq. Edhe unë, sikur këto parafolëset, jam anëtar i një familjeje që kemi shumë të zhdukur, mëse 18 nga fshati Rashiq. Ju përsëndes!

Ibrahim Bezeraj: Quhem Ibrahim Bezeraj, gjithashtu nga fshati Rashiq. Jam pjesëtar i të zhdukurve, vëllait, sikurse që i kemi 18 dhe për të cilët ende nuk dimë asgjë, pra janë të zhdukur.

Šabo Gutić: Zovem se Šabo Gutić, iz sela Raušić – Novij Raušić. Sin mi je nestao 18.6.1998. u selo Dubovijk i od tada pa do sada nikakvog traga ne možemo da udarimo za njega. Sve organizacije što postoje, prijavljeno je Crvenom krstu, UNMIK-u i KFOR-u i svima što postoje, izjavijli smo i ništa do sada – obaveštenja o njemu. Pa bih molio da se uzme to malo u obzir jer mi se čini da uopšte nije to uzimato u obzir.

Junuz Gutić: Ja se zovem Junuz, iz sela Raušića, nestao mi je brat u selu Dubovijku. Sve organizacije odavde do Amerike, sve znaju, ali šta je sada, ko je i koga će biti ne znam, ali stvarno znam da se ništa ne radi na ovom putu. Da li je to žrtva, nečija, bez obzira da li on Bošnjak, Albanac ili bilo koje nacije, bez obzira, ja vas molim da se ovo uzme u obzir za nas koji imamo nestale. Ne možemo vječno tražiti onoga koga mi želimo, pa vas molim sve ovde od Kandića, a zna se pod koga razumjevam Kandiću, da ona pošto sam po njezinom direktivom i ovde došao, pravo da vam kažem i ona me je tu dovela, pa molim od nje da se krene za sve žrtve ali najpre želim za sve Bošnjake pošto sam ja Bošnjak i želim vam da uspjevate u ovome i da nas obavjestite što prije. Hvala vam lepa!

Hilmo Kočan: Ja sam Hilmo Kočan, iz Zlopeka. Brat mi je nestao – Haćim Kočan, 9. marta 1999. godine. Nestao je ali mislim da je istog dana i ubijen. E, ne znam ništa, tijelo nismo mogli da pronadjemo. Ništa dalje, porduzimali su neke korake, ali ništa o tome, ne znam ali dobro bi bilo kad bi mogli te posmrtno ostatke da nadjemo, a sad bože moj, krivca ko je i šta, ide dalje. Toliko!

Brahim Gashi: Quhem Brahim Gashi, vij nga fshati i Dardanisë 3, jam si dëshmitar i pesë të vrarëve në Dardania 3.

Avni Melenica: Jam Avni Melenica, Vushtrri, përfaqësues i Shoqatës së familjave të personave të pagjetur 22 Maji.

Amel Sijarić: Ja sam Sijarić Amel. Meni je otac ubijen 15. oktobra 1999. godine, znači u posle ratnom periodu i od tada nismo u mogućnosti da nađemo ko je izvršio ubistvo i zbog čega.

Muniba Rastoder: Muniba Rastoder iz Vijtomirice. I ja sam došla u vezi moga muža. Moj je muž poginuo poslije rata. Ni dan dana se ne zna ništa. Prijavijla sam kod Italijana, odmah čim su ga odveli, ja sam njega prijavijo kod Italijana, sutra dan sam javila hodži, hodža nije mogao prijavijti. Ja sam otišla i prijavijla, kad sam se vratila, kuću su mu razrušili, obili su sve i morala sam da izađem sa četvoro djece i otišla sam za Ulcinj. 2. avgusta su našli, sahranili su ga, sin mu je iz Luksemburga došao i sahranio i došli su pa me našli u Ulcinj i javijli su da mi je muž poginuo. Ni dan danas se ne zna ni ko je, ni šta je. Ljudi su došli sa maskama, ispred kuće su ga uzeli od četvoro dece i od nene. Ja ne znam ni ko je ni šta, ni kako je. Mada su albanski pričali, ali ja nemam pojma, ja ne razumijem mnogo albanski, ja ne znam ni ko je ni šta je. I želela bih da se nađe, i ništa drugo, samo da se nađe i da se vidi gde su ova djeca ostala i kako su ostala. Znači, 11 godina nema ništa. Eto, toliko!

Nimon Shala: Unë jam Nimon Shala prej Rashiqi. Djalin e kam të humbur, 18 - krejt të fshatit janë të humbur.

Shkelzen Bezera: Quhem Shkelzen Bezera, vij nga fshati Rashiq. Babën e kam të zhdukur, mixhën, djalin e mixhës dhe 18 të fshatit i kemi të zhdukur e po ashtu edhe 14 dëshmorë. Faleminderit.

Avdyl Hyseni: Jam Avdyl Hyseni, nga fshati Zahaq. Unë dhe familja ime i kemi 6 të humbur, 5 i kemi gjetur kurse një jo, ai nuk është gjetur askund.

Erzen Basha: Quhem Erzen Bashka, nga Peja. Dy prindërit m’i kanë vra, por janë gjetur.

Naim Busurani: Jam Naim Busurani, vij nga Istogu dhe e kam vëllain e zhdukur.

Brahim Lajqi: Quhem Brahim Lajqi, vij nga fshati Llabjan, komuna e Pejës. Jam përfaqësues i viktimave civile, respektivisht të babës, babagjyshit dhe dy mixhallarëve që janë vra më 3 maj në fshatin Llabjan.

Azem Šaljunovijć: Ja sam Azem Šaljunovijć, inače došao sam zbog oca, kojeg su ga ubili 27 marta 1999.godine srpske snage.

Tahir Alimehaj: Tahir Alimehaj, vij nga Lubeniqi. Prezantoi familjen Alimehaj, të cilët janë të zhdukur – të vrarë 6 vetë, 4 i kemi gjet dhe 2 jo.

Avdi Thaqi: Quhem Avdi Thaqi, vij nga fshati Novosellë, komuna e Pejës. Përfaqësoj familjarët e viktimave të luftës.

Nuriye Mujaj: Quhem Nuriye Mujaj nga fshati Vrellë, komuna e Istogut – familje e dëshmorit.

Fatmire Dervishaj: Fatmire Dervishaj, nga fshati Zabllaç, komuna e Istogut, grua e dëshmorit.

Zaim Elezi: Ja sam Zaim Elezi, borac za ljudska prava, direktor Fondacije za zaštitu i unapredjenje ljudskih prava manjina na Kosovu. Inače bio sam član raznih međunarodnih komisija za genocid i žrtave rata VRIK, PAVK, zatim bio sam član isto Međunarodne radne grupe za povratak. I dalje se bavim ljudskim pravima. Trenutno sam član IFS koji se bavi nestalim licima.

Elbert Krasniqi: Elbert Krasniqi, prej TRENTINO CON IL KOSSOVO, Pejë.

Bardh Biba: Bardh Biba, nga Qendra rajonale ALM Mazreku, Pejë.

Haxhi Neziraj: Haxhi Neziraj, kuvendi komunal, Pejë.

Šućurija Kasumović: Ja sam Šućurija Kasumović, Nevladina organizacija Oaza Peć. Učesnik sam treninga REKOM-a odnosno KOMRA u Beogradu, koji je održan krajem oktobra.

Denis Begolli: Denis Begolli, Zyra ndërkombëtare civile, rajoni Pejë.

Amatilla Samoshi: Përfaqësueses i KFOR-it hungarez.

Lale Grabanica: Lale Grabanica, Elena Gjika, Klinë.

Bekim Blakaj: Edhe unë mbeta pa u prezantuar. Jam Bekim Blakaj, udhëheqës i Zyrës së Fondit për të Drejtën Humanitare në Prishtinë.

Besarta Vasija: Jam Besarta Vasija, nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Prishtinë. Jam koordinatorë për Kosovë – Koalicioni për KOMRA.

Veton Mujaj: Faleminderit të gjithëve. Së pari kisha dashur vetëm një sqarim të vogël, te zotëri Dauti. Është realisht gabim teknik që e kemi shkruar familjar i viktimave “civile”, është dashur të jetë e “dëshmorëve”, është gabim teknik. Ndërsa, sa i përket listës që e keni përpara, ajo është lista e njerëzve që po marrin pjesë sot, nuk është listë e të vrarëve ose të zhdukurve. Pra, është lista vetëm e njerëzve që janë këtu.

Unë desha të vazhdoj, për të ju njoftuar me atë se çka mendojmë të bëjmë sot. Realisht, ky nuk është takim i parë që po mbahet në rajonin e Pejës. Vitin e kaluar e kemi mbajtur një takim, por nuk ka qenë me familjarë, ka qenë vetëm me shoqërinë civile. Edhe ne si organizatë, që jemi prej Peje, edhe pse ndoshta në aspektin familjar direkt nuk e kemi pasur dikë të vrarë, e ndjejmë dhembjen. Së pari, unë personalisht dhe organizata ime e ndien dhembjen me të gjithë njerëzit që kanë të zhdukur, të vrarë, për punën që e kanë bërë luftëtarët, vështirësitë që i kanë invalidët, të gjithë. Prandaj, në njëfarë forme jemi munduar edhe ne të kontribuojmë me atë mundësinë sa e kemi. Në takimin e kaluar që e kemi pas, kemi pas shoqërinë civile, ku një pjesë shumë e madhe e organizatave të këtij rajoni, e që një pjesë e tyre është edhe sot këtu, e ka përkrahur këtë ide dhe janë të gatshëm edhe si shoqëri civile, me mundësitë e veta, për të ndihmuar gjatë krejt këtij procesi dhe me nda së paku këtë dhembje së bashku, nëse asgjë tjetër nuk mund të bëjmë. Kjo është pra edhe arsyeja kryesore edhe e takimit të sotëm që ne, në njëfarë forme, t’i shkëmbejmë këto mendime dhe të gjejmë gradualisht që së paku edhe një herë të na dëgjohet zëri ynë. Ne jemi shoqëri civile dhe nuk mund të vendosim, ne nuk jemi gjyq, por konkretisht dëshirojmë që në opinion edhe një herë të dëgjohet zëri ynë dhe gradualisht të gjejmë një zgjidhje të përbashkët që sidokudo t’ia lehtësojmë njëri-tjetrit vështirësitë që janë, edhe pse dhembja është shumë më e madhe dhe nuk ka mundësi ndoshta të mbulohet.

Faktikisht desha vetëm të tregoj se çfarë agjende do të kemi sot gjatë ditës. Domethënë pas këtij prezantimi të shkurtër të kësaj agjende, do të flas unë për këtë koalicion pak “Pse KOMRA”, pse është menduar të jetë ky koalicion. Për shkak se ne nuk jemi të vetmit që po mblidhemi në Pejë por janë të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë, njerëzit janë duke bisedar për këto çështje, në njëfarë forme për me gjet një zgjidhje dhe pse ka ardhur deri te kjo ide, do të mundohem pak të koncentrohem dhe të shpjegoj se ku janë aspektet tjera në këto vendet tjera dhe në regjionet tjera të Kosovës. Pastaj do të kalojmë me Bekimin, i cili pak më shumë do të na njoftojë me pjesëmarrjen në procesin konsultativ në vendet e ish-Jugosllavisë dhe do të na tregojë konkretisht se si shkon puna në Kroaci, në Serbi, në Bosnje, në Maqedoni, në Mal të Zi, po edhe në Kosovë pak më shumë, për shkak se Bekimi është shumë i informuar dhe sigurisht ka qenë një pjesë e madhe e familjarëve që e njohin Fondin për të Drejtën Humanitare në Kosovë me punën e tyre që janë duke e bërë. Pastaj, do të kemi Norën që vjen nga Koalicioni, e cila kryesisht do të na njoftojë me përvojat më të mira të verifikimit të fakteve në të kaluarën. Këtu nuk hyn vetëm puna e verifikimit të luftërave që kanë ndodhë, do të thotë në ish-Jugosllavi, por

kemi disa raste edhe jashtë, në vende tjera, qoftë në Afrikë, qoftë në Amerikën Latine që kemi disa raste që njerëzit edhe atje gjatë luftërave janë përballur me shumë vështirësi.

Do me thënë, pas kësaj – me Norën, do të mundohemi shumë shkurtë, realisht sepse ideja nuk është që ne me fol. Do të jemi krejt të shkurtër dhe pjesën e parë për një orë a një orë e gjysmë do ta kryejmë në mënyrë që të lëmë hapësirë për të gjithë juve. Ky është edhe qëllimi kryesor, por së paku ne vetëm deshëm të ju tregojmë se çfarë është kjo rrjedhë dhe besoj se diku pas përfundimit me Norën, do të mundohemi të shikojmë edhe një film. Ai film është i shkurtër dhe që tregon për këtë koalicion, si është duke shkuar. Është një pjesë që na tregon për çdo vend si është duke shkuar dhe pak i shohim edhe njerëzit që janë pjesë e tij. Në ora 11,20, që duket se jemi vonuar, do ta shtyjmë pra pak, varësisht dhe pastaj do të kemi një pauzë dhe në këtë rast është dreka, një drekë e lehtë që do të mundohemi së paku të mos mbesim unt. Pra, është një drekë dhe prej orës 12 deri në ora 15 me moderimin e Besartës, fjalën do ta kenë vetëm ju, jo ne. Për 3 orë me radhë ne presim vetëm ato shprehjet e mendimeve, të tregimeve prej anës tuaj dhe të dëgjojmë mendimin tuaj në këtë proces. Do të thotë kjo është përgjithësisht ajo çka parashohim gjatë kësaj dite të sotme të kemi në agjendë.

Unë kisha filluar me një material: Pse KOMRA, pse ky komision? Në shoqërinë e pas Jugosllavisë, do të thotë veç kur u shua Jugosllavia, krimet e luftës janë kryer në të gjitha anët, jo vetëm në një hapësirë, por në të gjitha prej këtyre vendeve janë kryer, dhe shpesh do të thotë palët i kanë theksuar, secila palë e thekson atë të veten, secili njeri e ka dhembjen më shumë te vetja dhe shpesh nuk e mat ndoshta edhe dhembjen e tjetrit kështu që shpesh këto edhe mund të keqpërdoren ose dikush tjetër me i arsyetu pak më mirë se sa dikush tjetër, kështu që shpesh viktima mbetet prapë si viktimë dhe nuk bisedohet shumë. Ekzistojnë identifikime të fuqishme të solidaritetit me të akuzuarit për krime të luftës. Viktimat janë harruar për opinion, do të thotë kanë kaluar, kanë kaluar jo vetëm në Kosovë por prej vitit 1991 që ka filluar lufta në Kroaci i kemi 16.252 njerëz të pa gjetur, do të thotë që janë të zhdukur dhe në njëfarë forme opinionit nuk po merret shumë, në njëfarë forme viktimat po janë më shumë pjesë e ceremonive dhe vetëm në ato ditë po vjen në njëfarë forme edhe gati po politizohen dhe më shumë po përdoren si elemente të ceremonive se sa një punë direkt që po bëhet për gjetjen e tyre ose për krijimin e një lloj komoditeti të veprimit të familjarëve të tyre ose të invalidëve të luftës apo në të gjitha aspektet ku janë vështirësitë, do të thotë, direkt me këta njerëz që kanë qenë aktorë dhe humbës kryesorë në ato vështirësitë e luftës, kryesisht me këta familjarë nuk është duke u marrë shumë jo vetëm në Kosovë por në të gjitha këto vende, do të thotë shumë pak nganjëherë i shndërrojnë në elemente, nganjëherë edhe në elemente politike, se sa që merren direkt për zgjidhjen e fatit, të dëshirave dhe nevojave që kanë këta familjarë. Për këta, do të thotë, duke i parë të gjitha këto rrethana ka ardhur deri te një ide për nisjen për një lloj koalicioni, që është quajtur KOMRA, mendohet për të jetë një komision ndërshtetëror, në mes të gjithë këtyre shteteve që kanë qenë pjesë e luftës, që do të jetë një lloj komisioni rajonal por shumë i pavarur, me kompetencë për gjetjen dhe paraqitjen publike të fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur, duke përfshirë këtu fatin edhe të zhdukure.

Historiati i kësaj nisme. - Pse erdhi deri te kjo nismë? Me qëllim që t'i tërhiqet vëmendja qeverive dhe opinionit për obligimin dhe nevojat me ballafaqimin mbi të kaluarën, 3 organizata, një prej Kroacisë, një prej Bosnjës dhe një prej Serbisë e kanë nisë një iniciativë. Domethënë, në këtë rast është Fondi për të Drejtën Humanitare, dokumente

prej Kroacisë dhe Qendra Hulumtuese-Dokumentuese prej Bosnjës që kanë thënë – hajde po mblidhemi dhe a mundemi ne si shoqëri civile të bëjmë diçka në atë kohë. Dhe kjo ka filluar diku në maj të vitit 2006. Fillimisht kanë filluar vetëm me debate mbi mekanizmat dhe vërtetësinë, një lloj debati që kishin mundur me qenë mekanizmat për të ardhur deri te vërtetësia e fakteve për këto gjëra.

Pastaj, forumi ar i gjithë këtyre, do të thotë i kësaj iniciative është mbajtur në Sarajevë, në maj të vitit 2006 ku kanë marrë pjesë prej të gjitha vendeve të ish-Jugosllavisë aktivistë të shoqatave të drejtave të njeriut, përfaqësues të familjarëve të zhdukur, viktimave, veteranëve, gazetarë, artistë, shkrimtarë, gjykatës, prokurorë, ekspertë që e njohin dhe dinë qysh me u marrë me të kaluarën dhe kryesisht do të thotë kanë qenë të përqendruar në atë qasjen rajonale të këtyre krimeve të ndodhura.

Ndërkohë, nisma për qasje rajonale në kontekst të kësaj nisme ka kaluar në themelimin e një komisioni për të vërtetën në nivel rajonal. Kjo ka ndodhur më 9 maj në Podgoricë, në një forum që është mbajtur prej të gjitha këtyre vendeve dhe kanë menduar se është mirë përpos të nismës të krijohet edhe një lloj komisioni për të vërtetën në nivel rajonal, i cili do të jetë i përqendruar në hapësirë dhe në këtë rast të përfshijë hapësirën e vendeve – të shteteve të ish-Jugosllavisë por edhe përfshin kohën, do të thotë prej vitit 1991 deri në vitin 2001. Çdo gjë, çdo rast dhe ideja është që çdo rast që kanë ndodhur prej këtyre viteve 1991 deri në vitin 2001 në njëfarë formë të jenë pjesë e shqyrtimit të këtij komisioni.

Qëllimi i KOMRA-s është që ta krijojë një shënim të saktë, zyrtar e objektiv për krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në periudhën kohore prej vitit 1991 deri në fund të vitit 2001; pranimi i viktimave dhe vuajtjeve të tyre, si dhe ndalimi i përsëritjes së krimeve. Në njëfarë forme, ne e shohim që nëse nuk merremi me atë çka ka ndodhur dhe nuk kalojmë për me i specifiku të gjitha rastet e asaj çka ka ndodhur, ne shohim se përsëri mund të na përsëriten elemente të njëjta, pra nëse ne nuk merremi me të kaluarën, si thotë një fjalë e urtë popullore: historia do të përsëritet dhe gjërat prapë mund të na shkojnë për keq. Prandaj është ideja që të merremi konkretisht me të gjitha rastet dhe në njëfarë forme të shërojmë shpirtin tonë dhe gradualisht mos të kemi nevojë që në të ardhmen të kemi prapë konflikte të njëjta në këtë rajon të Ballkanit. Përse KOMRA? Ne mendojmë po edhe të gjithë këta njerëz që kanë marrë pjesë nëpër këto forume mendojnë se me këtë iniciativë mund të parandalohet plasimi i disa gënjeshtrave në opinion. Dhe, nëse veç janë paraqitur këto gënjeshttra në opinion përgjithësisht ne besojmë se mundemi me tregu një lloj saktësie se a është e vërtetë ajo apo është gënjeshtër. Së paku, me këtë komision, ne besojmë se mund të fillojë të del e vërteta. Mund të ndërtojmë një platformë publike për zërin e viktimave me ndihmën e dëgjimit publik të viktimave. Do të thotë, në këtë rast është ideja që të kemi një platformë, të kemi një model se qysh të dëgjohet zëri i këtyre viktimave dhe së paku përmes dëgjimeve publike të krijohet edhe një ndjeshmëri edhe te publiku i gjerë, mos të jenë vetëm viktimat ata që për çdo ditë përballen dhe vrapojnë për t'u gjetur fati ose për t'u zgjidhur statusi i atyre njerëzve por të jenë edhe shoqëria në përgjithësi, shoqëria civile dhe politikanët, të gjithë ata dhe që opinioni të angazhohet jo vetëm përmes familjarëve por të angazhohen të gjithë pak më shumë që të krijohet një zë pak më i fuqishëm dhe të tregohet se ne nuk e lëmë pa dalë deri te e vërteta.

Ne mendojmë se ky komision, përmes kësaj iniciative, do të mund të formohet një regjistër i viktimave dhe humbjeve njerëzore dhe njëherë e përgjithmonë të ndalohet

manipulimi me numrin e të pësuarve në luftë dhe të vvarëve, pastaj inkurajimin e dëshmitarëve dhe viktimave për të marrë pjesë në gjykime për krime të luftës si dhe organizimin e dosjeve në raste të veçanta. Po besojmë se mund të ndihmojmë që të krijohet një frymë pak më e hapur dhe dëshmitarët që kanë qenë pjesë, të cilët nganjëherë edhe nuk guxojnë të flasin për do raste të caktuara, të krijohet një opinion i përgjithshëm që është mirë të tregohet se ku gjendet numri i një njeriut dhe se është mirë me ia lehtësu një familjeje ose një fshatit dhembjen që e ka për njerëzit e vet, sepse një njeri mund ta di një informacion që i lehtëson 18 njerëz. Ky është edhe një qëllim që ndoshta edhe mundet të bëhet diçka në atë drejtim.

Mund t'u ndihmojë komisioneve ekzistuese zyrtare për të zhdukurit në zbulimin e varrezave masive të pazbuluara dhe në zgjidhjen e fatit të zhdukurve. Kur merr një opinion të mirë dhe gjithë shoqëria pak më shumë ka një opinion pozitiv për të treguar të vërtetën, ne besojmë se shumë njerëz, shumë individë dhe me ato njohuri që i kanë ata – kanë me na dërgu ndoshta edhe deri te gjetja e disa varrezave tjera të njerëzve të pa gjetur të cilët nuk i kemi, ose ta kemi edhe një të vërtetë shtesë mbi rastet e pasqaruara që i kemi ende. Do të thotë, besojmë se hapja e këtij opinioni do të na ndihmonte shumë në shumë aspekte.

Mund të krijojmë mirëkuptim dhe tolerancë dhe të rikthehet dinjiteti i viktimave dhe familjarëve të tyre. Unë besoj se në këtë rast, sidomos në Kosovë, pas 10 viteve kryesisht për njerëzit e pa gjetur do të jetë një lehtësim shpirti, së paku nëse gjendet kufoma. Do të thotë në këtë rast, në njëfarë forme besojmë që së paku me gjetjen dhe njohjen e fatit të atij njeriu që ka vdekur ose që është zhdukë – besojmë që së paku familja ka me pas si lehtësim, familja ka me u ndie më e lehtë sepse së paku e di ku është.

Çfarë mendojmë se KOMRA mund të përfshijë? KOMRA nga e gjithë kjo, mendohet se do të jetë organ zyrtar i themeluar nga shtetet trashëgimtare të ish-Jugosllavisë. Do me thënë, organ zyrtar. Me fjalën zyrtar nënkuptohet se komisioni, nëse krijohet, krijohet prej parlamenteve të këtyre vendeve, krijohet prej Parlamentit të Kosovës, Parlamentit të Kroacisë, të Bosnjës dhe të gjithë këtyre tjerëve dhe duhet të jetë një komision zyrtar i të gjitha shteteve që kanë dalë prej ish-Jugosllavisë.

Tjetër, rreptësisht i pavarur nga themeluesit e saj. Në këtë rast, ne si shoqëri civile jemi vetëm iniciatorë. Ne nuk mund ta krijojmë këtë komision. Këtë komision e krijojnë qeveritë dhe parlamentet tona. Ky komision do të jetë absolutisht i pavarur prej neve. Ne vetëm po iniciojmë si shoqëri civile, si familjarë dhe tjerë që të kemi diçka si komision të tillë i cili do të ndihmojë, kurse parlamentet tona janë ato të cilat janë zyrtare. Ne më shumë jemi shtytës që ata të punojnë pak më shumë në këtë drejtim.

KOMRA do të jetë organ rajonal i cili përqendrohet në përvojën e viktimave. Ideja është se, jo që po thotë Vetoni ose Bekimi, duhet me marrë këso forme. Gjatë konsultimeve që po mbahen kudo dhe sot që jemi në Pejë dhe tentativa që ky komision është se niset prej përvojave të njerëzve, prej nevojave që ju i keni qoftë prej familjarëve të zhdukurve qoftë prej individëve të luftës, qoftë prej dëshmorëve, qoftë prej veteranëve të luftës, prej të gjithëve. Do të thotë është ideja e përcaktimit të këtij mandati nga ju që jeni pak më drejtpërdrejt të atakuar, me ndihmën e secilit. Do të thotë nuk është një send që ne po domi me krijuar, është një send që me idetë tuaja besojmë mund të krijohet. Pra, jo vetëm të Pejës e të rajonit të Pejës e të Kosovës por të gjitha vendeve të ish-Jugosllavisë.

KOMRA mendohet të jetë një organ i përkohshëm, i krijuar për një periudhë të caktuar kohore dhe i vendosur në territorin ku janë kryer krimet. Ky komision, pasi të krijohet

prej këtyre parlamenteve, duhet me pas një kohë të caktuar – një afat kohor varësisht prej asaj se çka kërkohet nëpër këto diskutime, a do të jetë ai 3 vjet, a do të jetë 5 vjet, për çka edhe Nora më vonë do të na tregojë për këto praktika dhe na tregon se nuk janë shumë të mira, ndoshta shumë të gjata, por brenda këtij afati kohor duhet ky komision të merret dhe të dalë me të vërtetën për secilin rast që ka ndodhur.

Duhet të jetë organ jashtëgjyqësor. Ne nuk shohim se do të jemi gjyq që gjykojmë dikë, mirëpo ne jemi njerëz me të cilët mundemi të sigurojmë fakte të vërteta, por që nuk marrim vendim në gjykatë mirëpo tregojmë dhe shpeshherë tregimet tona mund të jenë fakte kryesore për të cilat gjykata pastaj merr vendim.

Organ jo gjyqësor, i cili sjell konkludime lidhur me faktet për atë se çka ka ndodhur, bazuar në hetimet e veta dhe vërtetimin e fakteve gjyqësore por nuk sjell vendime gjyqësore dhe kjo është ajo pak më shumë që e thash. Organ hetues, i cili është i autorizuar për intervistimin e secilit që mund të sigurojë informata relevante për të krijuar hetimet multidisiplinare. Do me thënë, ideja është që mund të ketë mundësi që të ofrojmë ndihmë të nxirren intervista prej njerëzve tjerë që do të mund të ndihmojnë procesin për të dalë deri te e vërteta.

Organ i besueshëm që do të marrë parasysh vetëm deklaratat për krime lufte që janë konfirmuar të paktën nga dy burime të pavarura. Nuk mundemi me thënë se është një krim nëse së paku s'i kemi dy-tri burime që thonë se përnjëmend ka qenë krim, dhe është i zhdukur, se s'mundemi me thënë sepse duhet me ardhur deri te saktësia a ka qenë krim, a është zhdukur. Do me thënë nuk mund të themi se ky është kësi rasti, pa e vërtetuar se është ashtu.

Organ i cili askënd nuk e gjykon por mendon t'i emërojë autorët. Do të thotë, nuk e gjykon direkt si gjyq por mendon të thotë dhe së paku fjalën ta qet se ky ka qenë autor i krimin.

Organ hetues i cili në bashkëpunim me komisionet zyrtare për personat e pagjetur zhvillon hetime mbi faktin e të zhdukurve me dhunë. Mund t'i ndihmojë komisionet e pavarura për çdo aspekt, do të thotë me u dhënë informacion për çdo gjë.

Organ që përgatit rekomandime në drejtim të programit për rehabilitimin e viktimave. Do të thotë, mendohet se ky komision mund të jetë nismëtar për atë se si duhet viktimat, familjarët, invalidët të gjejnë një lloj rehabilitimi për ta, qoftë në formë kompensimi material dhe nganjëherë të vendoset, varësisht prej mandati, që familjarët të kenë një kompensim, varësisht se çka përcaktohet. Do me thënë është e mundshme që ne të propozojmë këtë formë që të ketë kompensim material, të ketë kërkim falje, të ketë ngritje të monumenteve, të qendrave memoriale, të hartave të kujtesës se ku kanë ndodhur rastet, të kenë një lloj gjithëpërfshirës të atyre rasteve të krimin.

Organ me kredibilitet që është i përbërë nga individë më eminentë të komunitetit në rajonin e tyre, përfaqësues të grupeve etnike, bashkësive fetare, të nominuar dhe të përzgjedhur në bazë të një sërë kriteresh të caktuara. Njerëz që duhet me përbërë këtë komision, do të thotë, mendohet të jenë njerëz me kredibilitet që në njëfarë forme e kanë besimin e gjithë juve, të gjithë njerëzve që janë pjesë e këtij procesi. Kështu, mendohet, në njëfarë forme të jetë ky komision. Dhe, ka shumë për me thënë e unë ua mora pak kohën këtyre kolegëve të mi, dhe, për mos me zgjatë shumë, fjalën e kisha bartur te Bekimi menjëherë.

Bekim Blakaj: Faleminderit, Veton! Edhe një herë, mirëdita të gjithëve!

Sot, për herë të parë, po më ndodh me pas emocione pak më ndryshe se në konsultimet tjera që janë mbajtur në vitin e kaluar për shkak të numrit të madh tuajin që keni ardhur sot. Dua edhe një herë me ju falënderuar, në emër timin tani, edhe pse e bëri Vetoni këtë. Dhe, për një çështje krejt tjetër, sepse, në mesin tuaj ka fytyra të njohura për mua, si zotëri Daut Elshani. Kam bërë intervistë një kohë, para shumë viteve me të. Më ka treguar se çka ka ndodhur me dëshmorët – me djemtë e tij. Bile më ka treguar dhe e mbaj në mend që menjëherë pas lufte edhe traktorin ta kanë vjedhur. A është kështu? E saktë! Kam qenë në Raushiq, kam biseduar me familjen Gjocaj, me zonjën Rastoder. Mua, po më kthehen të gjitha këto kujtime, tregimet tuaja se çka u ka ndodhur, vuajtjet tuaja. E përmendi edhe Vetoni. Nuk mund të jemi ne imunë për derisa i dëgjojmë këto tregime të tmerrshme që ju kanë ndodhur. As ne, nuk mund të jemi imunë prandaj edhe ne bashkëndejmë me ju.

Sidoqoftë, unë ishte dashur sot me ju folur, me ju shpjegua pak më gjatë për procesin e konsultimeve të deritanishme në të gjithë ish-Jugosllavinë, të gjitha vendeve të ish-Jugosllavisë. Mirëpo, nëse më lejoni, një minutë, për këtë që e tha edhe Vetoni, në një mënyrë pak më të thjeshtë edhe një herë me ju treguar.

Qysh prej vitit 2006 kanë filluar konsultimet prej disa organizatave për të drejtat e njeriut që merren me të drejtat e njeriut, që merren me çështjet e personave të zhdukur, të vrarë, me çështje të dëshmorëve e kështu me radhë. Kanë filluar konsultimet për mënyrën se çka ne duhet të bëjmë. Duke marrë parasysh se gjykimet për krime lufte në ish-Jugosllavi po edhe në Kosovë, posaçërisht, janë të pakta, numri i tyre është shumë i vogël. Është numër i madh i atyre që kanë bërë krime, por është shumë i vogël numri i tyre që janë arrestuar ose akuzuar dhe, edhe më i vogël, i atyre që janë dënuar. Familjarët e viktimave, viktimat nuk e kanë pa drejtësinë ende. Dhe, nëse vazhdohet me këtë hap kështu nëpër gjykata, unë kam frik se shumica prej familjarëve nuk kanë për ta parë drejtësinë.

Prandaj, është diskutuar shumë se cili kishte me qenë mekanizmi tjetër, një trup tjetër i cili në një mënyrë apo në mënyrë tjetër ka me nxjerrë të vërtetën në pah.

Gjatë atyre konsultimeve është ardhur ideja që një komision... Komisioni është organ zyrtar dhe nuk mundemi ta themelojmë ne, që e shpjegoi shumë mirë Vetoni, si organizata jo qeveritare. Komisioni duhet të krijohet prej shteteve. Mirëpo, ideja ka mbizotëruar që të jetë komision me karakter rajonal, jo shtetëror. Pse kjo ide? Ta marrim si shembull nëse krijohet një komision në Bosnjë. Ai komision në Bosnjë mund t'i intervistojë familjarët në Bosnjë mirëpo s'mund t'i intervistojë as t'i mbledhë dokumentacionet që janë në Serbi, ose në Kroaci. Gjithashtu, kjo vlen aq më shumë për Kosovë. Ne dimë shumë raste, kush janë kryerësit e veprës, kriminelët. Mirëpo, nuk mundemi me ardhur te ta, sepse janë në Serbi. Nuk mundemi të vijmë deri te dokumentacionet e ndryshme, të cilat, në fund të fundit mund të na ndihmojnë shumë për gjetjen e trupave të personave të pagjetur. Prandaj, qasja rajonale është shumë me rëndësi. Një komision i cili kishte me i mbuluar të gjitha shtetet kishte me qenë shumë më efikas, sepse nëse krijohet një komision i tillë atëherë ai komision do të ketë mandat t'i drejtohet institucioneve të ndryshme, ministrive të punëve të brendshme dhe me u thënë: ne na duhet dokumentacioni për këtë ngjarje. Dhe, nëse krijohet komisioni prej të gjitha qeverive atëherë gjithësesi do të vjen deri te ai dokumentacion. Prandaj, mos të marr më shumë kohë për këtë temë.

Komisioni ende s'është krijuar, ne jemi mbledhë, ekzistojnë 500 organizata të ndryshme të shoqërisë civile dhe individë që janë pjesë e koalicionit që kërkojnë të krijohet ky

komision. Dhe, në lidhje me këtë çështje është edhe ky konsultim i sotëm me ju. Ne kemi shumë dëshirë dhe mezi po presim t'i dëgjojmë idetë tuaja, qofshin ato për ose kundër një komisioni të tillë, por ndoshta keni edhe propozime të reja.

Unë tash po kthehem në rrjedhën e konsultimeve deri më tani. Është mbajtur një numër shumë i madh i konsultimeve qofshin në nivel lokal sikur këtë të sotme, do të thotë për një rajon, për rajonin e Pejës, qofshin në nivel nacional, do të thotë për krejt Kosovën mirëpo ka pasur edhe konsultime rajonale ku janë mbledhur organizatat joqeveritare prej krejt rajonit, prej Bosnjës, Serbisë, Kroacisë e Kosovës dhe kanë diskutuar për këtë çështje.

Tash po kthehem pak te qëllimet, sepse qëllimi kryesor kur është nisur ky proces, në vitin 2006, ka qenë, që e përmendi edhe Vetoni, të krijohet një platformë ku do të dëgjohet zëri i viktimave, zëri i juaj dhe ku keni me dalë dhe me thënë – unë kam problem, mua më janë zhdukur kaq anëtarë të familjes, nuk po i gjej e kështu me radhë. Do të thotë të krijohet një platformë ku ju, familjarët e viktimave, mund të tregojnë për atë se çka u kanë ndodhur dhe cila është nevoja emergjente për ta – identifikimi i trupave ose çfarë do qoftë tjetër.

Qëllim tjetër i procesit konsultativ ka qenë edhe fuqizimi i kësaj përkrahjeje rajonale. Do të thotë përkrahja juaj ndaj kësaj ideje për t'u krijuar komisioni rajonal. Do të thotë për ne shumë me rëndësi është përkrahja juaj dhe nëse ju thoni: po na duhet të bëhet ky komision, atëherë ne më lehtë mundemi me shty këtë punë përpara.

Ky është qëllimi i dytë. Në konsultime, po më duket që kanë ndodhur në maj të vitit 2008, është dalë propozimi i saktë që duhet të krijohet një komision rajonal për përcaktimin e fakteve për krime lufte dhe për krime tjera të rënda ndaj njeriut. Do të thotë, këto janë tri qëllimet e procesit konsultativ deri më tani.

Dua të ndalem pak për çfarë është biseduar gjatë këtyre konsultimeve. Janë marrë dhe shumë tema janë nisur. Dua të jem i sinqertë, disa ende përgjigjen nga ato tema nuk e kemi të qartë. Unë do të shkoj me rend për to.

Gjatë konsultimeve shumë pjesëmarrës e kanë ngritur temën, se ai komision kur të krijohet, me çka do të merret. A do të merret me hulumtimin e krimeve, do të thotë me hulumtimin e pasojave apo duhet të merret edhe me hulumtimin e shkaqeve. Për çfarë ka ardhur deri te ato pasoja? Do të thotë kanë ekzistuar dy mendime të ndryshme.

Megjithatë, shumica e pjesëmarrësve në të gjitha konsultimet, janë pajtuar që komisioni duhet të merret me krimet që kanë ndodhur, për t'i hulumtuar krimet. Dhe, pastaj, për shkaqet, duhet të merren njerëz tjerë, profesionistë se pse ka ardhur deri te ato krime. Mirëpo, ka pasur të tillë dhe mund të them se historianë me renome në krejt territorin e ish-Jugosllavisë, të shteteve tash prej Kosove e deri në Slloveni ka pasur që kanë thënë në fakt – komisioni duhet të merret edhe me shkaqet, do të thotë, pse ka ardhur deri te lufta edhe me pasojat – cilat krime janë bërë, duhet hulumtuar. Do të thotë, për këtë temë kur është diskutuar ka pasur mendime të ndryshme.

Dua të flas shkurtimisht, sepse s'e kam ndërmend me ju marrë shumë kohë sepse po dua t'ju dëgjoj edhe juve, mirëpo po dua të flas edhe për mandatin e komisionit për të vërtetën. Domethënë, të gjithë ata që e kanë përkrahur, e përmenda edhe më herët, janë mbi 500 organizata dhe individë prej krejt ish-Jugosllavinë që e përkrahin dhe qëndrojnë pas kësaj ideje për t'u krijuar ky komision dhe e kanë marrë parasysh propozimin, mund të them, numri më i madh i familjarëve të viktimave. E kjo është për personat e zhdukur. Komisioni gjithsesi duhet me u marrë me çështjen e personave të zhdukur, t'i evidentojë

ata cilët janë dhe sigurisht me u marrë me hulumtimin dhe gjetjen e dëshmimeve se ku janë dhe ku gjenden, ku janë varrezat masive apo çfarë ka ndodhur me ta. Do të thotë komisioni – KOMRA, që po i themi, komisioni rajonal duhet të merret me çështjen e personave të zhdukur, pa kurrfarë dyshimi. Dhe kjo duhet të definohet me ligj. Për ndryshe, nëse krijohet komisioni që ne po shpresojmë, çdo shtet i ish-Jugosllavisë por edhe Kosova duhet ta nxjerrin një ligj lidhur me komisionin dhe me u përcaktuar mandati i komisionit në bazë të atij ligji.

Gjithashtu, komisioni duhet me u marrë edhe me vrasjet, do të thotë jo vetëm me personat e zhdukur, por me ata që janë vrarë, që është gjetur trupi i tij menjëherë dhe është varrosur nga ana e familjarëve. Pra, me krime të rënda dhe me atë duhet të merret. Për dhunimet, sidomos shoqatat e grave të cilat kanë marrë pjesë në konsultime, e kanë cekur në rend të arë që komisioni duhet të merret edhe me hulumtimin e dhunimeve që kanë ndodhur dhe me i gjet faktet, dëshmitë për atë çka ka ndodhur.

Është e ditur se këto kanë ndodhur më shumë në Bosnjë e Hercegovinë nga ana e shoqatave të ish-Jugosllavisë, ata i thonë “llogorashëve”, të atyre që janë mbajtur nëpër llogore. Edhe për këtë ka dal propozimi që komisioni duhet me u marrë edhe me kampet që kanë ekzistuar, ku janë mbajtur në mënyrë të paligjshme njerëzit.

Ka pasur edhe ide të tjera, për shembull se komisioni duhet me u marrë edhe për dëbimet masive që kanë ndodhur. Kjo ka ndodhur edhe në Kroaci, në Bosnje dhe në Kosovë, siç e dini edhe ju vetë.

Dhe, një çështje tjetër, të cilën disa gazetarë – pjesëmarrës në këtë procesin konsultativ, e kanë cekur disa herë dhe është thënë se komisioni duhet të merret edhe me përgjegjësinë e institucioneve, por edhe me përgjegjësinë e mediave, respektivisht të gazetarëve, të cilët një kohë kanë bërë, të themi ashtu, marketing për ato qeveri ose për ata njerëz që kanë prodhuar dhunë, kanë prodhuar luftë. Ata i kanë promovuar. Do të thotë, edhe gazetarët dhe mediat i kanë përgjegjësitë e veta për këtë çka na ka ndodhur në territorin e krejt ish-Jugosllavisë.

Të flas pak lidhur me gjykatat për krime lufte. Çfarë qëndrimi duhet me pas komisioni në raport me gjykatat për krime lufte? Të gjithë pjesëmarrësit e konsultimeve kanë thënë se komisioni duhet t’i përkrahë gjykatat për krime lufte.

Të gjitha materialet – dëshmitë që janë nxjerrë para Tribunalit të Hagës duhet komisioni t’i marrë ato, t’i shfrytëzojë. Mirëpo, ato të cilat janë vërtetuar me aktgjykime, do të thotë është nxjerrë aktgjykimi dhe ato me i marrë si fakte të kryera.

Ka pasur mendime të ndryshme lidhur me gjykatat nacionale që merren me krime lufte, me cilësimet ligjore që i kanë nxjerrë disa gjykata, qofshin ato të Kroacisë, Bosnjës, Serbisë apo të Kosovës, do me thënë, që aty duhet pasur një rezervë lidhur me cilësimet që i kanë bërë, ose me konkluzionet që i kanë pru ato gjykata.

Po ashtu, është biseduar dhe besoj se mbizotëron ideja që dokumentacioni i Tribunalit të Hagës respektivisht arkiva, i gjithë ai dokumentacion i Tribunalit të Hagës duhet të shfrytëzohet prej komisionit rajonal në mënyrë që të kihet sa më shumë fakte dhe sa më shumë prova për krimet që janë bërë.

Regjistrimi i viktimave. - Të gjithë pjesëmarrësit e konsultimeve, qofshin ato nacionale, qofshin në Kosovë, qofshin në rajon, janë pajtuar që komisioni duhet ta bëjë një regjistrim të viktimave, respektivisht të vrarëve, të zhdukurve, të dhunuarve e kështu me radhë.

Disa organizata për të drejtat e njeriut, duke e përfshirë edhe organizatën time ku punoj - Fondin për të Drejtën Humanitare, për Kosovë, IDC është një organizatë që merret me të drejtat e njeriut në Sarajevë dhe Dokumente në Zagreb, veç janë duke punuar në këtë projekt. Tash mos të dal prej teme, por organizata ime deri më tani i ka regjistruar 13.000 viktima në Kosovë, të vrarë dhe të zhdukur, me emër, me mbiemër, me të dhëna personale dhe me atë se çfarë u ka ndodhur atyre, rrethanat si janë vra apo si janë zhdukur. Kjo, për herë të parë në histori, pas një lufte kaq të madhe, po ndodh që dikush ta bëjë regjistrimin emër për emër të viktimave dhe jo me u thirrur në numra e me thënë janë “20.000”, por me emër për emër, jo veç lista, po edhe të dhënat e tyre personale, statusi martesor, punësimi, e kështu me radhë, në mënyrë që ne si organizatë do ta nxjerrim një publikim dhe ata do t’i prezantojmë si njerëz e jo si lista, jo si numra, sepse ata ju mungojnë juve, iu mungojnë shoqërisë së vet dhe neve na mungojnë si shoqëri dhe është obligim yni, i shoqërisë, që ata të mos harrohen. Ne nuk guxojmë t’i harrojmë ata, sepse mund të na ndodh të përsëritet prapë. Së paku këtë përgjegjësi e kemi edhe ndaj gjeneratave të ardhshme, me ua lënë një dokumentacion për ata që të dinë se çfarë ka ndodhur. Mos ta zgjas me këtë.

Regjistrimin e viktimave duhet ta bëjë edhe komisioni rajonal, e këtë ne mund t’ua ofrojmë, mirëpo komisioni si një trup ligjor, do të thotë zyrtar, duhet t’i verifikojë pastaj ato të dhëna. Nuk është se duhet të na besojë ne, por duhet t’i verifikojë dhe si do qoftë e kanë shumë më lehtë kur i kanë të dhënat me adresa se ku jeton familja dhe më lehtë mund të vijnë deri te familjet e tyre. Do të thotë regjistrimi i viktimave është një ndër mandatet e komisionit rajonal.

Shumë është debatuar për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit, kush do të jetë anëtar i komisionit, si ka me u zgjedh.

Komisioni duhet të jetë reprezentativ. Anëtarët e komisionit duhet të jenë prej të gjitha vendeve të ish-Jugosllavisë. Çka është me rëndësi? Në komision duhet të jenë të përfshirë edhe viktimat, edhe ju. Edhe gratë. Do të thotë duhet të jetë një strukturë, në përqindje, njëjtë të përfshirë në komision.

Aktivistë për të drejtat e njeriut. - Çka është më me rëndësi, në komision duhet të jenë personalitete të respektuara që s’e kanë asnjë njollë në të kaluarën, sigurisht që nuk janë kanë të dënuar për krime, e tjera dhe të jenë persona kredibilë për të gjithë.

Struktura e komisionit. - Është debatuar gjatë. Ende nuk është mbërrirë një përfundim i qartë, por parashihet që në çdo vend të ketë nën-komisione. Do të thotë, ekziston komisioni qendror por në çdo vend të ish-Jugosllavisë nën-komisione, bile ka pasur propozime të tilla, të cilat kanë qenë shumë pozitive që komisioni ta ketë një zyre, për shembull, në vend ku ka pasur shumë viktima, ku ka pasur shumë krime, ta zëmë në Pejë, në Gjakovë. Do të thotë ka edhe ide të tilla.

Është diskutuar shumë, duke u shërbyer edhe me përvojën e tjerëve për dëgjimin publik të viktimave. Në shumë komisione, duke filluar prej atij të Afrikës Jugore, është aplikuar kjo mënyrë, ku viktimat janë ftuar të dhënë deklaratën publikisht para komisionit. Kjo ide ka hasur në përkrahje të madhe, sidomos nga shoqatat e ndryshme që i përfaqësojnë viktimat. Në atë mënyrë kishte me u arritur dhe krijuar një solidaritet në mes viktimave të etnive të ndryshme dhe ka pasur ide që këto dëshmi të dëgjimeve publike të viktimave të shfaqen edhe nëpër televizione në mënyrë që të dëgjohen edhe në vende tjera, e kështu me radhë.

Qëndrimi i komisionit ndaj kryerësve të veprës. - Kjo është një temë e cila gjithashtu është rrahë shumë gjatë debateve dhe ka pasur kundërthënie në këtë aspekt, sepse është shtruar edhe pyetja e amnistisë: a duhet viktimat të amnistohen apo jo? Sigurisht, nga pikëpamja e viktimave, është shumë vështirë që ata të pranojnë të amnistohen pra viktimat. Mirëpo, ka pasur ide nga ana tjetër se çka nëse kryerësi i veprës ofron të dhëna për krimet, si kanë ndodhur, ose për varrezat masive. Çka nëse një kryerës i veprës mund të ofrojë të dhëna në mënyrë që të identifikohen personat e zhdukur. Do të thotë, është debatuar shumë për amnistinë. Vetoni e përmendi se komisioni duhet t'i emërojë përgjegjësit që i kanë kryer krimet, me u bë një listë dhe me thënë: këta janë ata të cilët i kanë kryer krimet.

Dhe, pika e fundit, për të cilën do të flas – është pajtimi. Në fillim të konsultimeve nuk është diskutuar fare dhe nuk është përmendur pajtimi. Mirëpo, në ndërkohë, ka pasur pjesëmarrës të konsultimeve të cilët e kanë prek këtë temë dhe mund të themi se nuk është mbërri asnjë konsensus lidhur me pajtimin: se a duhet me u marrë me pajtim komisioni apo jo. Shoqatat e viktimave kanë qenë kundër kësaj, në shumicën e rasteve. Ka pasur tjerë që e kanë përmendur pajtimin mirëpo ka pasur edhe të tillë që kanë thënë: është çështje kohe, duhet kohë për pajtim. Dhe, në fund të fundit, ky është një proces social, kështu që ende, do të thotë, nuk jemi të sigurt a do të përfshihet pajtimi në mandatin e komisionit rajonal.

Unë pata kaq. Shpresoj se do të kemi pyetje prej juve, do të kemi edhe ide të reja, këshilla e kështu me radhë. Ju faleminderit, edhe një herë shumë!

Veton Mujaj: Faleminderit, Bekim shumë! E di që e the një pjesë goxha të madhe të gjërave dhe shpresojmë edhe Nora, nëse ka diçka me shtua, se një pjesë goxha të madhe edhe Bekimi e tha.

Nora Ahmetaj: Mua nuk mu la shumë për të folur këtu sot, mirëpo për shkak të respektit i kisha përmendur disa raste të vendeve tjera në botë ku janë formuar komisione të ngjashme, eventualisht komisione nacionale, por jo komisione rajonale sikur ky që tentohet të formohet në Kosovë dhe në rajon. Prandaj, duhet t'i sjell disa përvoja të disa vendeve tjera.

Arsyen se pse jeni thirrur, pse jeni ftuar ju këtu, nuk po e përsëris. U përmend se në mungesë të punës së mirëfilltë të gjykatave, e ne e dimë konkretisht në Kosovë çfarë gjykata kemi dhe sa ato janë efikase në zbardhjen kur flasim për krimet e luftës, atëherë themelimi i një komisioni rajonal, jo vetëm i gjykatave dhe sundimit të ligjit në Kosovë por në gjithë rajonin do t'ua lehtësonte punën, ngase do të merren konkretisht me krimet e të gjitha luftërave që kanë ndodhur në ish-Jugosllavi në 10-vjeteshin apo 15-vjeteshin e fundit.

Arsyeja e dytë është shumë me rëndësi se shoqëria civile duhet të marrë pjesë në mobilizim... Shoqëria civile në këtë kontekst, po mendoj jo vetëm organizatat joqeveritare, asociacionet, grupet e veteranëve të luftës por edhe të gjitha ato grupet më të fragmentizuara që janë në shoqëri, është mirë të mobilizohen në mënyrë që të dihet se çka po ndodhë, të dihet çka po ndodh dhe jo me ardhur për shembull, ose qeveritë në rajon me marrë ose me nënshkruar ndonjë marrëveshje dhe atëherë shoqëritë këtu me i qit para aktit të kryer.

Përvojat e vendeve tjera kanë treguar, sidomos ato përvojat e shteteve të Amerikës Latine, ose për shembull në Kili, apo Argjentinë, për shkak të rregullimeve politike ose sistemeve politike që i kanë pasur është bërë qasja, siç thuhet në shkencë, ka qenë prej

lartë-poshtë, kur qeveritë eventualisht presidenca me dekrete të ndryshme kanë vendosur të formohet një komision dhe nuk e ka pyetur fort popullin ose viktimën apo asociacionet a jeni ju të pajtimit për këtë qasje a jo, por kanë shkuar me njëfarë mënyre me urdhër të prerë dhe ato komisione ku janë formuar ashtu, ose sikur që në Guatemalë është formuar një komision i tillë, nuk janë treguar të suksesshme për arsye se shoqëria civile edhe një herë ka qenë e pa informuar por edhe nuk ka marrë pjesë në proces dhe në momentin kur ti nuk e ke popullatën që të merr pjesë në proces, e vetëdijesuar dhe e cila i thotë nevojat e veta dhe e cila lufton për shembull ta kthejë dinjitetin e viktimave, normalisht se shtetet fort edhe s'qajnë kokën sepse i kanë agjendat e tyre. Do të thotë këto përvoja na bëjnë ne me marrë leksione dhe kemi përvoja më të mira. Përvoja shumë më e mirë është komisioni që është formuar me kontributin maksimal të Nelson Mandelës në Afrikën e Jugut dhe numërohet ndër komisionet më të suksesshme për arsye se aty ideja dhe nevoja janë shpreh, janë vë në pah edhe prej familjarëve të viktimave dhe prej shoqërisë. Për këtë arsye edhe qasja në gjithë rajonin ka qenë që të mblidhen shoqëritë civile dhe shoqëria civile me iniciuar këtë punë dhe me bë presion te qeveritë në rajon ose konkretisht shoqëria civile e Kosovës të bëjë presion te Qeveria e Kosovës me i mbledh nënshkrimet dhe me thënë “po”, ne jemi dhe po domi që ky komision me u formua në mënyrë që të zbardhet fati i atyre që janë zhdukur, në mënyrë që të dihet çka është bërë ose që t'u kthehet dinjiteti viktimave, që të kërkojnë dëmshpërblime prej dhunuesit në këtë rast – nëse evidentohet që Serbia, Kroacia, Bosnja, Kosova e kushdo që ka kryer krime, nuk po them në këtë rast vetëm për Serbinë, që të evidentohet, të merren faktet e mirëfillta dhe mandej viktimat të kenë edhe afat kohor dhe viktimave t'u kthehet jo vetëm dëmshpërblimi ekonomik por edhe dinjiteti. Do të thotë, ka përvoja të ndryshme prej vendeve të ndryshme.

Ky komision nuk ka me kryer punën e gjykatave, sepse ky komision fokusin kryesor do ta ketë viktimën. Për shembull, në gjykata viktimat mund të shkojë, mund të ankohe, mund të jep mendimin e vet, mund të jetë dëshmitarë. Mirëpo, mos të harrojmë se në gjykata janë edhe avokatët të cilët e mbrojnë palën kundërshtuese dhe shpeshherë e qesin viktimën në pozitë shumë të pavolitshme nga se ai edhe është i diskriminuar, mirëpo avokati i palës dhunuese vjen dhe e mbron dhunuesin kështu që nëpër gjykata viktimat, në njëfarë mënyre, është psikikisht dy herë viktimë. Pra, ky komision ka me u marrë vetëm me viktimat. Viktima ka me qenë absolutisht primare.

Për më shumë, nëse veç vendosim me viktimat, kur mblidhen faktet, me viktimat do të punojnë edhe psikologët, do të vendoset që ato viktimat a do të flasin haptas në publik apo viktimat do të flasin vetëm në ambiente të mbyllura dhe do të thonë a do të ballafaqohen me dhunuesin, me atë që e ka kryer krimin – nëse gjendet, apo nuk donë. Do të thotë është proces shumë më i gjatë se që ne na merr mendja dhe kur të vjen puna deri aty atëherë është një grup i ekspertëve po edhe i psikologëve të cilët do të punojnë individualisht me viktimat. Nuk është kjo punë sikur po ju thërrasim ne juve ose po e thërrasim dikë: hajde tash këtu me dhënë një deklaratë dhe ditën e mirë. Pra, është shumë proces i gjatë, shumë i mundimshëm, shumë i dhembshëm dhe emocional.

Kur është puna te formimi i komisioneve dhe mandati i tyre do të them se shkarazi u përmend se këto komisione do të formohen prej njerëzve me kredibilitet. Çka do të thotë – me kredibilitet? Ata njerëz do t'i propozoni ju. Sa komisionarë do t'i ketë Kosova, në këtë rast? Shkon pak edhe me proporcion të popullatës dhe me numrin e Po ma merr mendja, janë disa kritere aty që janë me norma ndërkombëtare të caktuara. Mirëpo, ata

persona do të jenë njerëz të cilët nuk janë të involvuar politikisht, ata njerëz të cilët kanë një respekt shumë të madh në shoqëri dhe shoqëria ua beson barrën për të qenë komisionarë, njerëz të cilët do t'i lexojnë të gjitha dëshmitë, ankesat dhe të cilët me shumë ndjeshmëri do të merren me këtë punë. Nuk mund secili ta prezantojë veten ose eventualisht me thënë: unë po dua me qenë komisionar. Mirëpo, ju mundeni të propozoni, nëse vjen puna deri aty, dhe atëherë vendoset.

Po ju tregoj një rast. Për shembull në Afrikën e Jugut, Nelson Mandela kur e ka kërkuar listën e njerëzve komisionarë, i është dorëzuar një listë prej 50 e më shumë personave, prej krejt shtetit. Do të thotë Afrika e Jugut është shtet shumë më i madh se Kosova. Ai e ka reduktuar atë listë, ka kërkuar të infiltrohet, të reduktohet në 25 persona. Mbetja e atyre 25 personave, ai i ka marrë edhe 2 persona të cilët nuk kanë qenë të përzgjedhur dhe ata kanë qenë prej opozitës ose prej personave të cilët ndoshta i kanë irrituar anëtarët tjerë, e kanë irrituar shoqërinë civile mirëpo për shkak të dis balansit politik ai ka marrë dhe i ka futur edhe 2 persona tjerë dhe në mesin e tyre tek pastaj është shkuar me 5 ose 6 komisionarë. Do të thotë, procesi i filtrimit të komisionarëve është shumë – shumë i ndjeshëm dhe duhet të kalojë nëpër shumë analiza. Nuk mundet pra secili me thënë unë jam unë, mendoj jam njeri adekuat dhe po e propozoj vetveten.

Te financimi i komisioneve. - Ka komisione në botë që formohen prej Kombeve të Bashkuara. Për shembull e kemi komisionin në Liberi dhe në disa shtete tjera, edhe në Guatemalë dhe në Timorin Lindor. Për shembull Kombet e Bashkuara pas konfliktet vendosin se këtu është më së miri me formua një komision të pavarur dhe në atë moment kur Kombet e Bashkuara sikur këtu që kanë qenë UN ose UNMIK-u vendosin me themelua komisionin por edhe e bartin barrën e financimit. Mos ta harrojmë punën e financimit. Konform sistemeve politike në një vend kush vendos me zgjedh me formua komisionin ai edhe do ta bartë barrën e financimit. Po qe se ekzekutivi vendos, i takon qeverisë. Po qe se legjislativi vendos, i takon parlamentit. Po qe se presidenti ka ingerencë më të madhe dhe me ndonjë dekret special vendos, atëherë duhet me u pa si duhet të financohet. Po, ai që vendos dhe kjo ka qenë përvojë në të gjitha shtet, do ta bartë barrën kryesore për ta financuar këtë komision. Mos të harrojmë këto komisione janë shumë të shtrenjta, shkojnë deri në 10 milionë dollarë dhe me zhvillimin e teknologjisë që jemi duke jetuar ne sot mund të jetë edhe shumë më shumë. Në Amerikë të Jugut, po më duket ka qenë 5 milionë dollarë, mirëpo ajo ka qenë para 20 viteve. Këto komisione kushtojnë shumë. Komisionarët me i pagua kushtojnë shumë. Hulumtuesit, që hulumtojnë, pastaj edhe do të ketë vullnetarë shumë të cilët do të punojnë vullnetarisht për të hulumtuar në terren, por s'do të thotë që vullnetarët nuk duhet të paguhen me shuma simbolike.

Përbërja e komisioneve, gjithashtu, është shumë komplekse. Komisionet parashohin të jenë efektive nëse punojnë me tempo shumë të ngjeshur 2 deri 3 vjet. Mirëpo, po qe se komisionet sikur ky rajonal janë të këtij kalibri atëherë me siguri edhe kohëzgjatja do të jetë më e gjatë. Komisionet përfshijnë një numër të madh të njerëzve të cilët punojnë, mund të jenë edhe 200 vetë, meqë po flasim për komisionet dhe përvojat e komisioneve rajonale nëpër botë. Dhe me qenë se ne po tentojmë të formojmë komisionin rajonal, unë besoj se numri do të jetë shumë më i madh mirëpo me zhvillimin e teknologjisë prapë ndoshta do të ketë modalitete tjera pak më të sofistikuar se në komisionet tjera.

Gjithashtu, rekomandimet, për shembull nëse shoqëria civile e përpilon mandatin e atij komisioni, ia dërgon qeverisë ose parlamentit dhe parlamenti e debaton. Nuk do të thotë

se ju tash keni me shkua te shtëpia dhe mos me u marrë më me atë punë dhe me prit tash çka do të bëjë parlamenti. Në asnjë mënyrë! Duhet me vazhdua me lobu dhe nëse ne shohim se është në interesin tonë afatgjatë, duhet vazhduar të llojmë, duhet vazhduar me bë presion, duhet me pa nëse rekomandimet në mandat të komisionit nuk zbatohen duhet bërë edhe më shumë presion. Unë, personalisht, jam e mendimit që ne duhet të bëjmë presion e mos të presim që bashkësia ndërkombëtare të bëjë presion nga se nevojat tona nuk i di bashkësia ndërkombëtare. Ne e dimë se çka është më e mirë për ne, edhe pse nganjëherë nuk po lëvizin punët ashtu shpejt si po domi, atëherë zakonisht po presim të ndërhyjë bashkësia ndërkombëtare. Pra, puna juaj, ose puna e shoqërisë civile nuk do të thotë se në momentin që qeveritë ose parlamentet vendosin për pranimin apo aprovimin e këtij komisioni ose jo dhe ne mos të mundohemi të bëjmë kurrfarë aktiviteti tjetër.

Dëgjimet publike. - Me këtë edhe po e përfundoj. Kur fola për viktimat dhe viktimat ndoshta do të punohet në mënyrë shumë të ndjeshme, konform vendit dhe specifikave ose kulturave të atij vendi, do të vendoset se a do të shkohet me dëgjime publike apo jo. Çka janë dëgjimet publike? Nëse ne dëshirojmë që fëmijët tanë të mos përjetojnë më luftëra, të mos përjetojnë atë nëpër çka kemi kaluar ne, atëherë është mirë që ata ta dëgjojnë një të vërtetë tjetër, një të vërtetë kur, për shembull, i shohin në televizion dëshmitarët të cilët e thonë atë çka e kanë përjetuar, atë çfarë u ka ndodhur atyre. Kjo është shumë e fortë, edhe emocionalisht, edhe psiqikisht me duru dhe me pa, por është treguar se në disa vende, sidomos në Afrikën e Jugut dhe në disa vende të Amerikës... edhe në Maroko edhe në Kili se aty kur kanë folur viktimat – kanë qenë aq bindëse dhe të forta sa që edhe njerëzit më të informuar dhe më të shkolluar kanë mbetur pa tekst për arsye se s'kanë besuar që dikush – regjimi i tyre kanë mund ta bëjnë një gjë të tillë, për shembull, ndaj pakicave ose popujve aborixhinj.

Dëgjimet publike e kanë jehonën shumë të madhe, e kanë mesazhin shumë të fortë dhe kanë ndikim shumë të madh te brezat e ri të cilët duhet ta shohin një të vërtetë tjetër në mënyrë që të mos përsëritet. Mirëpo, duke marrë parasysh se disa vende janë më patriarkale dhe disa vende janë kofnorm specifikave të atij vendi, ndodh që, për shembull kur është diskutuar me gratë e Bosnjës të cilat kanë qenë të dhunuara gjatë luftës së fundit, nuk kanë pranuar që ato të dalin publikisht dhe ta tregojnë dëshminë se si kanë qenë të dhunuara prej disa pjesëtarëve të forcave të armatosura. Kështu që, edhe ne me gratë në Kosovë kur e kemi pasur këtë debat, gratë tona gjithashtu kanë cekur se do të ishte shumë e vështirë për viktimat kosovare, për gratë e Kosovës me dalë në dëgjime publike dhe me folur ose dëshmuar në mënyrë publike për atë se çfarë iu ka ndodhur. Mirëpo, këto janë modalitete të cilat ju do të vini me mendimet e juaja dhe i propozoni e mandej ne i rishikojmë se a bën në Kosovë, a kishte me qenë një dëgjim publik i kapshëm dhe i mirë dhe a kishte me pasur jehonë të duhur, apo jo – në mënyrë që pastaj ajo të aprovohet në momentin kur edhe nëse parlamentet vendosin që një komision të tillë ta pranojnë.

Unë po ndalem këtu dhe nëse ju do të keni pyetje, atëherë unë do të përgjigjem me kënaqësi. Faleminderit!

Veton Mujaj: Faleminderit, Nora! Ne, për shkak edhe të kohës që filluam më vonë, tash kishim kaluar te pjesa e filmit ta shikojmë pastaj në drekë dhe do të kthehemi menjëherë pas drekës për diskutimet së bashku me ju. Kështu që po vazhdojmë tash me filmin. Ju kisha lutur, teknikisht ta jepni filmin dhe të ndalim rrymën, me qëllim të shihet më mirë, ndoshta.

(Shfaqja e filmit)

Besarta Vasija: Fillojmë me sesionin e dytë. Unë jam Besarta Vasija dhe do ta moderoj këtë sesion të diskutimeve. Së pari unë desha të ju falënderoj edhe një herë që keni gjetur kohë për të ardhur në këto konsultime, që janë shumë të rëndësishme për gjithë ne.

Prej përvojës, pasi që ne e dimë se shpeshherë shumë vendime janë marrë në emër të viktimave dhe pa i pyetur fare viktimat, pa i pyetur për nevojat e tyre, pa i dëgjuar ata ose edhe shpeshherë kanë hasur në veshë të shurdhër, prandaj ne kemi menduar se është shumë me rëndësi që ne të fillojmë me një metodë tjetër, ku ne do të krijojmë një hapësirë për familjarët e viktimave të cilat kanë vuajtur më së shumti si gjatë luftës ashtu edhe pas luftës. Ne sot e hapim këtë diskutim dhe dëshirojmë që kjo kohë të jetë vetëm e juaja, ku do të flisni për nevojat tuaja, ku do të na tregoni se si duhet të duket ky komision, ku do të na propozoni neve se cilat krime duhet të përfshihen, si do të zgjidhen komisionarët, çka mendoni kush do të jetë pjesë e saj, a duhet të merremi me pasojat e luftës, a duhet të merremi me shkaqet e luftës dhe nëse keni pyetje ose nuk keni diçka të qartë ne i kemi këtu panelistët të cilët janë mjaft të informuar rreth kësaj dhe mund të ju përgjigjen. Tani e hap diskutimin dhe kushdo që mendon se duhet nisur, le të urdhërojë.

Ju kisha lutur edhe diçka. Pasi që i tëri ky konsultim incizohet dhe kjo mbetet i dokumentuar, sa herë që ta merrni fjalën, ju kisha lutur, të prezantoheni me emër e mbiemër. Faleminderit! Urdhëroni, zonjë!

Emine Bytyqi: Quhem Emine Bytyqi, vij nga fshati Rashiq, pra prej një fshati që i kam 18 anëtarë të fshatit të pa gjetur përkatësisht të zhdukur – që u murr ky emër mjaft i rëndë për ne familjarët. Vetë ardhja jonë dëshmon se ne si familjarë të anëtarëve të pagjetur jemi të interesuar se si të ndriçohet fati i tyre. Ju, zoti Blakaj, thoni që mos të harrohen, por për fat të keq, janë harruar sepse po të mos ishin harruar, që 11 vjet po të ishte marrë seriozisht nuk do të kishte kaq numër të madh të pagjeturve, apo do të mbetet rasti i tyre si një letër pa adresë që nuk arrin askund çështja e tyre. Pra, që 11 vjet bredhim rrugëve në çdo anë dhe nuk kemi asgjë konkrete për rastin e tyre. Mirëpo, për fat të keq, apo për fat të mirë, nuk di edhe si të shprehem, kemi të bëjmë me një shtet që nuk e njeh gjuhën e dialogut. Ju kisha lutur juve, që e keni këtë iniciativë dhe ju përgëzoj dhe uroj suksese në të ardhmen, që të merrni hapa më konkret sepse e keni përkrahjen edhe prej nesh si familjarë dhe do t'ju përkrahim me mundësitë tona sa të mundemi dhe të ndriçohet rasti i çdo viktime, i çdo të pagjeturi anembanë rruzulli brenda Jugosllavisë apo veçanërisht Kosovës, që ne e përfaqësojmë një fshat dhe i kemi 18 të pa gjetur dhe bredhim rrugëve me ankth. Ju falëndero, ndoshta nuk dita as si të shprehem sepse kam emocione dhe është vështirë që ta përshkruaj rastin e të vetmit vëlla, për të cilin që 11 vite jam duke bredhur rrugëve dhe nuk di asgjë konkrete për rastin e tyre se ku janë, ku mbetën. Ata i mori dikush. Ata që i morën kanë qenë ushtarë, e kanë përfillur një shtet, ai shtet e ka pasur komandën, prandaj për këtë duhet me u marrë seriozisht dhe shumë lehtë do të ishte të ndriçohen rastet e tyre. Ju falënderoj!

Besarta Vasija: Faleminderit! Bekimi, dëshiron të flas. Urdhëroni!

Bekim Blakaj: Unë dua ta falënderoj shumë zonjën Bytyqi edhe për pjesëmarrje edhe për përkrahjen që na jepet ne në këtë proces. Mund ta kuptoj shumë mirë gjendjen tuaj dhe nuk është fare lehtë që edhe pas 11 viteve të mos dini për fatin e më të dashurit tuaj.

Unë vetëm dua ta marr një shembull. Më duket se gjatë filmit të cilin e shikuam, një person e përmendi. Ne sot këtu e kemi edhe një person që na ka ardhur nga Vushtrria dhe

më kujtohet kur e kam intervistuar. Ai i ka gjetur anëtarët e familjes së vet, pas disa viteve. Dhe kur e kam intervistuar e kam pyetur se qysh është ndie kur i ka gjet. Më ka thënë se ajo ditë ka qenë si ditë që e ka pasur gëzimin më të madh.

Ekzistojnë institucionet, konkretisht në Kosovë ekziston edhe Komisioni qeveritar për persona të zhdukur, të cilët së bashku me institucionet tjera ndërkombëtare, sikur që është Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur dhe po punojnë në drejtim të identifikimit. Mirëpo, për fat të keq, rezultatet nuk janë ato të priturat, prandaj edhe ideja për t'u krijuar një komision i tillë është që të ndihmojë në zbardhjen e fatit të personave të pa gjetur. Edhe kur përmenda se me cilat shkelje duhet të merret, në rend të parë ishin personat e pa gjetur.

Ka pasur përvoja të ndryshme në komisionet paraprake nëpër botë që janë krijuar dhe më i suksesshmi ndër më të suksesshmit për identifikimin e personave të pa gjetur është treguar Komisioni i Marokut. Nuk mund të thirrem tash në numra të saktë, sepse nuk i mbaj mend, por ka qenë një numër shumë i madh – me mijëra të zhdukur atje dhe kur komisioni e ka përfunduar punën e vet, kanë mbetur vetëm edhe 40 persona të pa gjetur, kështu që po shpresoj se komisioni si mision primar do ta ketë hulumtimin e fatit të **personave të pa gjetur. Faleminderit!**

Besarta Vasija: Faleminderit! Urdhëroni!

Emine Blakaj: Unë ju falënderoj shumë dhe uroj suksese që sa më shpejt të ndriçohet rasti. Faleminderit shumë prej jush, zoti Blakaj.

Besarta Vasija: Faleminderit, shumë! Dikush tjetër? Kushdo që ka pyetje, apo rekomandime, mund të paraqitet. Urdhëroni, së pari zonja, pastaj ai zotëria atje.

Fatmire Dervishaj: Jam Fatmire Dervishaj, nga komuna e Istogut. Pyetja ime do të ishte kështu: Cili shtet, në ish-Jugosllavi kuvendi i së cilës e ka miratuar këtë iniciativë? Cili shtet: Serbia, Bosnja a Kroacia?

Besarta Vasija: Faleminderit! Le të bëhet edhe pyetja tjetër, pastaj do t'u përgjigjet zonja. Urdhëroni, zotëri Zaim!

Zaim Elezi:

Besarta Vasija: Faleminderit! Pyetjes së zonjës Fatmire do t'i përgjigjet Nora, e pastaj, Bekimi.

Nora Ahmetaj: Në rregull, Fatmire! Cilat shtete në ish-Jugosllavi e kanë miratuar iniciativën këtë komision? Po, procesi është duke shkuar paralelisht në krejt shtetet e ish-Jugosllavisë, që kanë dalur nga ish-Jugosllavia. Këto shtete janë Serbia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Kosova. Tash vonë është involvuar në konsultime edhe Maqedonia për shkak të konfliktit në vitin 2001 dhe do të involvohet edhe Sllovenia, për arsye se edhe ato kanë qenë pjesëmarrëse në konfliktin e kaluar gjatë shpërndarjes së shtetit të Jugosllavisë.

Procesi në asnjë vend nuk ka shkuar diku përpara diku prapa. Konsultimet, pak më të ngjeshura gjatë vitit 2008 kanë qenë në Kosovë, po edhe në vitin 2009 po ashtu. Është paraparë një plan i përbashkët që në gjithë rajonin të shkojë njëjtë dhe deri kah gjysma e vitit 2010 ne me i përfunduar në parim konsultimet edhe lokale e nacionale. Pra, në të gjitha shtetet mbahen konsultimet nacionale dhe qysh ne i mbajmë edhe këtu, të njëjtën kohë mbahen në Serbi, Bosnjë e Hercegovinë, Kroaci dhe do të fillojmë edhe me Maqedoninë. Kah gjysma e 2010 përfundojnë konsultimet, fillon mbledhja e nënshkrimeve. Është paraparë se në gjithë rajonin duhet të jenë 1 milionë nënshkrime dhe ajo ndarja proporcionale e nënshkrimeve shkon 1 në 20 banorë një nënshkrim. Kosovës,

sikur e kemi llogaritur me 2 milionë e 200.000 banorë i bie diku 110.000 nënshkrime me i pas. Bosnja ka tjetër numër. Serbia ka tjetër, sepse ka banorë më shumë. Kroacia ka tjetër. Do të thotë mbledhja e nënshkrimeve do të zgjatë 4 muaj, do të trajnohen ekipe, do të trajnohen vullunterë të cilët do të dalin me i marrë nënshkrimet. Në momentin kur bëhen 1 milionë nënshkrime, mos të harrojmë, secili shtet i ka ligjet e veta. Vetoni është më ekspert për ligje sa i përket votave, mirëpo ligjet e vendeve relevante do të merren para sysh. Në momentin kur ne i mbledhim nënshkrimet, aq sa nevojiten, atëherë ato nënshkrime depozitohen në parlament. Ende nuk dihet modaliteti i saktë, a do të shkohet... sepse krejt ky proces shkon në mbikëqyrje të bashkësisë ndërkombëtare. Prandaj, mos të harrojmë këtë. Këtë nuk e thamë, mirëpo krejt procesi shkon në mbikëqyrje dhe përkrahje maksimale nga bashkësia ndërkombëtare. Kur e them – bashkësia ndërkombëtare, dihen: Komisioni Evropian, Shtetet e Kuintit, do të thotë vendimmarrës të cilët janë në skenën globale. Dhe, në momentin kur ne i mbledhim nënshkrimet, që parashihet të jetë fundi i vitit 2010, atëherë nënshkrimet i depozitohen parlamentit dhe Parlamenti i Kosovës e debaton këtë punë.

Veç t'ua jap një informatë. Parlamenti i Afrikës Jugore ka debatuar 300 orë se a ta pranojë komisionin a jo. Kjo ka ndodhur para 20 viteve gati. Do të thotë parlamenti ka shumë punë dhe nuk jemi ne ata që vendosim për këtë. Secili parlament në shtetin bazë do ta debatojë këtë punë. Nuk do të shkojë procesi në Kosovë më përpara se në Bosnje, Serbi ose Kroaci. Datat janë të njëjta, ka me shkuar paralelisht. E tash a do të ketë ndonjë modalitet tjetër, apo a do të ketë ndonjë marrëveshje ndërkombëtare ku liderët do të merren vesh e pastaj liderët ua japin parlamenteve me i legjitimuar ato marrëveshje, ajo është punë që u takon politikanëve, ne vetëm me marramendje, me hipoteza të flasim për këtë. Mirëpo, kjo është procedura. Asgjë nuk ka ndodhur, asnjë parlament nuk ka miratuar asgjë. Krejt shkon me plan dhe në momentin kur edhe mbledhen nënshkrimet atëherë, sikur thash, e jona kryhet, shoqëria civile e përfundon punën e vet dhe e observon, e monitoron tash çka po bën parlamenti. Sepse, s'do me thënë që ne kur ta kryejmë punën e nënshkrimeve, të tërhiqemi dhe t'i themi parlamentit: – ju bëni çka doni. Jo! Sepse është në interesin e viktimave, është në interesin e familjarëve, në interesin e krejt shtetit po edhe të gjeneratave të ardhshme. Do të thotë, ne edhe më tutje duhet të bëjmë presion që ata të mos e politizojnë shumë këtë çështje. Kështu qëndron puna, kështu janë planet.

Fatmire Dervishaj: Në qoftë se Kuvendi ynë e miraton këtë, për të ardhmen e kam fjalën, se këtu duhet shumë punë me u bë, atëherë mbetet me u miratua edhe në Kuvend të Serbisë, të Kroacisë dhe të Bosnjës. Këto që priten me u bë. Unë jam shumë e sigurt se Kuvendi i Serbisë këtë nuk do ta bëjë, sepse ata janë njerëzit që kanë bërë krim. Shumë e sigurt jam!

Veton Mujaj: E përmendi Nora, do të thotë për 1 milionë nënshkrime dhe pse po i mbledhim. Ta zëmë për Kuvendin e Kosovës, për me shkua pra një çështje në Kuvend të Kosovës nuk ka nevojë më shumë se 10.000 nënshkrime. Mirëpo ne në Kosovë po i mbledhim 110.000 nënshkrime. Ideja është që t'i mbledhim në rajonin e ish-Jugosllavisë 1 milionë nënshkrime, sepse me ligj të Parlamentit Evropian një çështje fillon të diskutohet në Parlamentin Evropian nëse janë të mbledhur 1 milionë nënshkrime. Kosova i ka 10.000, Serbia, më duket i ka 30.000 për një afat të caktuar, ndërsa Parlamenti Evropian e ka 1 milionë nënshkrime. Qëllimi ynë është që me këto 1 milion nënshkrimeve, përpos këtyre vendeve ta ngucim pak edhe Parlamentin Evropian dhe

tentativë e jona do të jetë që në njëfarë forme nëse kemi shtete që në këtë rast edhe u përmend Serbia, që ndoshta nuk e pranon këtë, të ketë një lloj presioni prej së larti. Është tentativë ndoshta, jo vetëm për Serbinë, por për të gjitha vendet tjera që, nëse ky komision, ose ky mandat i komisionit do të jetë shumë i qartë dhe shumë i mirë – atëherë shtytja jonë ka me qenë që të angazhohen të gjithë aktorët që kjo me u bë reale nga të gjitha parlamentet.

Bekim Blakaj: Unë desha t'i përgjigjem zotëri Zaim Elezit. Së pari do ta falënderoj për pjesëmarrje, për parashtrimin e pyetjeve dhe komenteve.

U përmend se disa familjarë të personave të zhdukur kanë dyshime se mos është bërë identifikimi gabimisht i personave prej familjeve të tyre dhe ku duhet ata me u lajmërua në rast se donë ta bëjnë edhe një herë ri-identifikimin në bazë të metodës së ADN-ës. Unë mendoj se adresa më e saktë për ta shtruar këtë çështje është OMPF i thonë, shqip i bie Zyra për Personat e Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore në Prishtinë. Kjo zyre momentalisht nën kompetencat e EULEX-it. Ai institucion është institucioni më kompetent ku duhet kërkuar që të bëhet ri-identifikimi me metodën e ADN-ës. Megjithëkëtë rasti mund të lajmërohet edhe në Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur i cili lëndën pastaj e procedon në instanca tjera. Do të thotë, unë besoj se Zyra Ligjore për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore nuk e refuzon asnjë kërkesë të tillë. Ata, në fakt, janë të interesuar që sa më shumë të bëhen identifikime të sakta.

Ndërsa, unë nuk kam njohuri së paku që në vitet e fundit, cilido institucion që merret me çështjen e personave të zhdukur insiston që t'i dorëzohet trupi familjes pa ekspertizë – pa ADN, ose mos të them – me identifikim në mënyrë tradicionale.

Siç e dini ju të gjithë, e sidomos familjet e personave të pa gjetur, diku rreth 400 mbetje mortore janë në hapësirat e këtij instituti për mjekësi ligjore, sepse nuk ka identifikim pozitiv, në fakt mostrat e gjakut janë marrë prej familjarëve por ato nuk rezultojnë pozitive me mostrat e eshtrave. Mund të jenë shumë arsye, mirëpo unë personalisht besoj se arsyeja ose problemi kryesor është se ndoshta menjëherë pas përfundimit të luftës shumë familjarë kanë bë eshumimin e varrezave masive edhe në mënyrë tradicionale – në bazë të rrobave ose të një shenje - kanë konstatuar se ai trup i takon familjes së tyre dhe pastaj e kanë bërë varrimin, e në ndërkohë nuk e kanë dhënë gjakun për analiza. Prandaj, ka mund të ndodh të bëhet ndonjë identifikim i gabuar, dhe me këtë edhe mund t'i kemi të gjithë ata trupa që ende qëndrojnë në hapësirat e institucionit për mjekësi ligjore. Unë edhe kisha bërë apel për të gjithë familjarët, sepse ne kemi shpesh familjarë që na vijnë në zyre dhe thonë këtë që e thatë ju: Po domi të jemi të sigurt a e kemi varrosur familjarin tonë apo jo. Do të thotë i inkurajoj të gjitha ato familje të cilat dyshojnë në atë, që edhe një herë ta procedojnë rastin. Faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit Bekim! Ndokush tjetër? Unë ju kisha lutur të gjithëve që të ndiheni lirshëm. Kjo është hapësirë e juaj. Urdhëroni, zonjë!

Muniba Rastoder:

Besarta Vasija: Hvala puno! Dikush tjetër? A do ndokush të përgjigjet në pyetjen e parashtruar? Urdhëroni!

Amel Sijaric:

Besarta Vasija: Faleminderit! Bekim?

Bekim Blakaj: Unë do të tentoj të përgjigjem shkurtimisht edhe për zonjën Rastoder edhe për zotëriun Sijaric.

Në këtë rast ju duhet të insistoni gjithë kohën në polici që të vazhdojnë hetimet, që të mos ndërkrehen hetimet për të marrë vesh për fatin e familjarëve tuaj, edhe pse ju, do të thotë, i keni varrosur trupat e tyre. Mirëpo, sidoqoftë kjo është nevoja e familjarëve të viktimave që ta dinë të vërtetën – pse ka ndodhur, kush e ka bërë dhe të kërkojnë përgjegjësi. Do të thotë, do të kthehem prapë në atë sesionin e para ditës sot kur fola. Personat e zhdukur duhet të kenë mandatin kryesor për komisionin, mirëpo edhe krimet tjera të rënda – vrasjet, dhunimet e kështu me radhë. Pra, besoj se edhe për këto raste komisioni kishte të ndihmojë shumë mirëpo në këtë fazë dhe në këtë moment unë ju kisha sugjeruar ju që prapë të insistoni te organet e sigurisë dhe të hetuesisë që të merren me rastet tuaja. Faleminderit!

Besarta Vasija: Dikush tjetër? Urdhëroni! Urdhëroni, zotëri!

Tahir Rraci: Jam Tahir Rraci, ish i burgosur politik dhe përjetues i masakrës në Dubravë. Përshëndes nismën tuaj për formimin e këtij komisioni dhe çdo nismë tjetër që çon kah zbardhja e personave të zhdukur dhe të vrarë, por edhe të atyre që kanë bërë krime - është e mirëseardhur dhe e mirëpritur nga popullata. Për mua, kjo është brenga ime më e madhe.

Unë nuk do të flas për përjetimet në burgun e Dubravës, për atë veç e kam dhënë një deklaratë para sa vitesh te zoti Blakaj dhe njerëzve tjerë kompetentë dhe është bërë publike ajo masakra e Dubravës, por çka më shtyri të flas, kam pak shpresë në funksionimin e këtij komisioni duke pasur parasysh vetë shtetin serb.

Ne të burgosurit politikë, në krye me Reshat Nurbojën, Jahja Llukën e disa shokë tjerë kemi bërë një grevë të urisë para burgut të Dubravës me datën 20.9.2000 e cila ka zgjatur 8 ditë. Në atë kohë ka qenë Kouchneri, krye-administrator këtu. Kouchner e ka dërguar përfaqësuesin e vet, ishte në Nju-Jork atëherë, i kemi parashtruar disa kërkesa, të cilat na janë pranuar dhe të cilat prej asaj dite nuk janë realizuar. Një ndër ato, duhet të përmendi:

1. Kërkesën për ish-drejtorin e burgut të Dubravës Aca Rakocevic dhe ish-komandantin e burgut Miki Vidic t'i emërojë publikisht kryerësit e masakrës së Dubravës dhe të tregojë ku i kanë dërguar kufomat e shokëve tanë të vrarë me atë rast.
2. Kërkesën nga ish-mbikëqyrësi i burgut të Dubravës Branko Komatina që të prononcohet publikisht se kujt ia ka dorëzuar Ukshin Hotin të dielën më 16.5.1999, sepse ai ka qenë personi i fundit i cili e ka marrë nga pavijoni dhe e ka shoqëruar gjer në dalje të burgut të Dubravës. Në të kundërtën, ai kurdoherë do të përgjigjet për të gjitha ato që i kanë ndodhur shokut Ukshin Hoti.
3. Nga Gjyqi i Hagës kërkojmë ngritjen e menjëhershme të padisë kundër përgjegjësve të masakrës së burgut të Dubravës prej datës 21 deri më 24 maj 1999.
4. Kërkojmë nga Këshilli i Sigurimit që të caktojë një emisar. Atë e ka caktuar.
5. I kemi bërë apel edhe kryetarët të ri të Komisionit Ndërkombëtar për të Zhdukurit në komisionin të cilin ai e kryesonte, të ofrojë një shpërblim ndërkombëtar për të gjithë ata që kanë informacione dhe që sjellin deri te zbulimi i mijëra personave të zhdukur në Kosovë.

Pra, këto kanë qenë disa nga kërkesat. Por çka ndodhi? Asnjëra prej tyre s'është e plotësuar. Ndërkohë, me datën 27, kur neve na u ofrua ta ndërpresim grevën, kishim bërë

8 ditë grevë të urisë, përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm e ka pasur një brifing në Nju-Jork, po atë ditë.

Po i citoj disa nga fjalët nga zoti Kouchner pranë Këshillit të Sigurimit, më 27 shtator 2000.

Një problem tjetër i cili rëndon situatën është fati i personave të zhdukur dhe i të burgosurve. Më vjen keq që e mërzis këshillin me këtë problem. Unë e kam cekur këtë problem këtu disa herë më parë dhe më vjen mirë që Komësariati për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara ka emëruar një delegacion special që të merret me fatin e personave të burgosur dhe të zhdukur, por frikohem se nuk do të arrijë shumë për kosovarët e burgosur dhe të zhdukur nëse bashkësia ndërkombëtare nuk bën presion të madh në Beogradin në mënyrë që Beogradi të ndryshojë qëndrimin e vet kokëfortë.

Nuk do të zgjas më shumë. Mirëpo, një organ më i lartë se Këshilli i Evropës, se qeveritë tona, se qeveria në Serbi është Këshilli i Sigurimit. Njerëzit e tij kanë qenë këtu dhe sot e asaj dite nuk kanë mund të ndryshojnë diçka për të mirë.

Juve ju uroj punë të mbarë, ju uroj sukses dhe e keni mbështetjen tonë dhe të gjithë atyre që i kanë të zhdukur familjarët. Ju faleminderit shumë!

Besarta Vasija: Faleminderit! Urdhëroni, Nora!

Nora Ahmetaj: Zotëri Rraci, unë vetëm do ta jap një mendim timin dhe ndoshta është politik, por tek e fundit, për atë edhe jam e shkolluar dhe po e lidhi pak me këto informatat lidhur me komisionin.

Në qershor të vitit 2009, verën e kaluar, kur zonja Kandiç e fitoi një çmim shumë të madh prej shoqërisë civile në qytetin e Ferizajt me ç'rast na thirrën edhe ne dhe ishim mbledhë aty. Dhënia e atij çmimi ishte iniciuar mu prej të burgosurve politikë. Siç e dini qyteti i Ferizajt ka pasur shumë të burgosur politikë të cilët në një mënyrë ose tjetër Fondi dhe zonja Kandiç, vetë personalisht është munduar gjatë 1998 dhe 1999 po edhe më herët të bëjë diçka për lirimin jo vetëm të atyre të burgosur por edhe të burgosurve tjerë në burgjet e Serbisë. Dhe, si sot e mbaj mend, është përmendur drejtori i burgut të Dubravës por edhe drejtori i burgut CZ në Beograd, në Pozharevac dhe për burgjet tjera të Serbisë. Burgjet janë nën hierarkinë e ministrisë së drejtësisë dhe në atë kohë po dihet se kush ka qenë ministër i drejtësisë në kohën e Millosheviqit o edh përpara bile edhe emrat dhe mbiemrat i kam diku të shkruar, por tash s'po më kujtohen.

Sikur që ju thatë, Këshilli i Sigurimit është organi më i lartë i cili nuk ka mund ta zgjidhë këtë problem. Këshilli i Sigurimit nuk po mund ta bindë Serbinë që Ratko Mlladiqin ta dorëzojë, e nuk po mundet as Komisioni Evropian. Nuk po munden as të gjitha ato shtete të cilat në njëfarë mënyre po donë me i dhënë grand për ta futur në Bashkësinë Evropiane, sepse ata e kanë Mlladiqin por nuk po e japin. Do të thotë, duhet dhe e drejtë e jona qytetare është që të provohen të gjitha mënyrat, të gjitha opsionet sepse gjithmonë ku ka probleme ka edhe opsione dhe mundësi se si të shtyhet ai shtet për t'u ballafaquar me krimet dhe me i dorëzuar kriminelët e luftës.

Çka mundet të bëjë komisioni? Ne e përmendëm që kur të përpilohet mandati i komisionit do të detajzohen krimet të cilat do të hyjnë të hulumtohen dhe verifikohen dhe njëri prej atyre krimeve do të jetë edhe për të burgosurit e burgut të Dubravës ose për të pagjeturit. Ata të pagjeturit janë të zhdukur nga dika, ata s'janë marrë vetëm prej shtëpive por edhe prej burgjeve, prej rrugëve dhe fabrikave. Dhe kjo, nëse hyn në mandat të komisionit dhe shoqëria civile është ajo që duhet ta draftojë dhe të thotë: jo ju ta draftoni për ju t'i jepni sugjerimet dhe unë po dua që të zhdukurit e burgut të Dubravës

me hy në mandat të komisionit dhe atëherë në momentin kur aprovet dhe parlamentet të pranojnë këtë komision normalisht se ato do të verifikohen. Dhe, atëherë ne do të nisemi dhe supozojmë me shpresë se në momentin kur Serbia ashtu sikur të gjitha shtetet tjera nënshkruan dhe merr përgjegjësitë për gjetjet e këtij komisioni dhe merr përgjegjësi që atë çka e gjen komisioni dhe ka me i kthye dëmshpërblimet, ajo nuk ka qare pa i dhënë të dhënat që i ka në arkiva dhe ne e dimë që ata i kanë ato të dhëna nëpër arkiva të shtetit për atë se ku dhe çka ka ndodhur.

Prandaj, ne po nisemi prej kësaj premise dhe tash është hipotetike edhe sa e pranon parlamenti i Serbisë një komision. Ne po e dimë se Serbia më së shumti do të japë llogari nga se ka qenë inicuese e 4 luftërave, mirëpo e jona është që të mundohemi, e jona është që ta fusim edhe çështjen e burgut të Dubravës dhe të zhdukurit në kërkesën tonë për komision dhe pastaj çka bëjnë parlamentet është pyetje tjetër, por edhe të mos kalojmë në këtë pyetje, por të kalojmë në pyetje tjetër.

Pra, ma merr mendja, tash ne nuk duhet të hipotezojmë dhe të themi tash nuk del asgjë prej kësaj pune dhe se Këshilli i sigurimit nuk ka bërë asgjë, por pse mos me provua këtë. Diçka duhet me dalë në fund.

Besarta Vasija: Faleminderit! Urdhëroni, Bekim!

Bekim Blakaj: Unë i kuptoj shumë mirë shqetësimet e zonjës Dervishaj dhe zotëri Tahirit dhe jemi shumë të vetëdijshëm se me çfarë sfide kemi të bëjmë. Sfida është shumë e madhe. Prandaj ne na duhet përkrahja juaj dhe po kërkojmë përkrahje nga ju këtu dhe gjithkund në çdo vend, në mënyrë që ta arrijmë qëllimin dhe të bëjmë presion te çdo shtet dhe, jo vetëm te Serbia, që të krijohet ky komision.

E përmendi Vetoni shifrën e 1 milionë nënshkrimeve dhe kjo është me rëndësi të madhe dhe thjeshtë asnjë qeveri dhe asnjë shtet nuk mund të injorojë 1 milionë nënshkrime. Faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit! Urdhëroni, a dëshiron kush tjetër?

Pasi që gjatë vitit 2009 kemi pasur një proces shumë intensiv të konsultimeve dhe gjatë atyre konsultimeve kanë dalë rekomandime të ndryshme. Edhe Bekimi, më herët e tha që kemi pasur pjesëmarrës të cilët kanë menduar se na nevojitet një komision rajonal i cili do të merret vetëm me pasojat, do të thotë, me evidentimin e krimeve dhe çka ka ndodhur saktësisht, kurse një pjesë tjetër e pjesëmarrësve ka menduar se ndoshta duhet të fillohet edhe me shkaqet.

Unë ju kisha pyetur edhe juve se çka mendoni, a duhet ne të bëjmë presion për themelimin e një komisioni për t'u evidentuar të gjitha krimet që kanë ndodhur në Kosovë dhe rajon, pa marrë parasysh nacionalitetin, apo na duhet të hulumtojmë edhe më thellë dhe të kërkojmë pse erdhi puna deri këtu që të kemi luftë.

Pastaj, a pajtoheni ju që ky komision të hulumtojë vetëm krimet, sikur që janë, për shembull zhdukja, dhunimet, masakrat, torturat ose mendoni se duhet hulumtuar edhe diçka tjetër. Lidhur me këtë e dëgjuam edhe zotëriun për burgun e Dubravës. Kemi pasur raste ku pjesëmarrësit kanë kërkuar edhe hulumtimin e helmimeve të nxënësve në shkolla. Disa tjerë, për shembull, kanë propozuar të hulumtohet edhe rasti i vrasjeve të ushtarëve në kazernat e ushtrisë së ish-Jugosllavisë. Kjo iniciativë është diçka shumë serioze dhe bëhet vetëm për hir të viktimave. Do të thotë, kjo është hapësirë e juaj. Unë ju kisha lutur të gjithëve të ndiheni të lirë dhe t'i thoni brengat tuaja dhe t'i jepni rekomandimet tuaja se çka duhet hulumtuar ky komision, me cilat krime të merret. Pastaj, është edhe problemi tjetër se a duhet të emërohen kriminelët. Kemi raste për shembull,

sikur që na tregoi Nora, përvojat e shteteve të tjera që kanë pasur komisione dhe ku janë emëruar kriminelët – krimbërësit. Kemi pasur edhe vende ku është ndaluar kjo për hir të asaj se, në qoftë se emërohen kriminelët atëherë ka gjasa që parlamenti të mos e aprovojë, sepse në shumicën e shteteve në parlament ka edhe njerëz të cilët mund të akuzohen për krime të luftës. Ekziston edhe problemi tjetër, që u paraqit nëpër konsultime, se a duhet me i dhënë amnisti kriminelëve të luftës nëse ata neve na japin informata mbi atë se ku janë varrezat masive ose ku janë të zhdukurit.

Do të thotë, këto janë probleme të cilat e prekin gjithsecilin prej nesh dhe lidhur me këtë kërkojmë mendime nga ju, kërkojmë rekomandime nga ju se si duhet të duket mandati i këtij komisioni. Ju jeni të rëndësishëm dhe mendimet tuaja për ne janë të rëndësishme. Nuk po dëshirojmë të krijohet një mandat pa i ditur nevojat tuaja. Prandaj, ju kisha lutur të ndiheni shumë të lirë për t'u kyçur në diskutim. Ne jemi këtu për ju. Urdhëroni!

Fatmire Dervishaj: Arsyeja pse është ardhur deri te vrasja, zhdukja, ndjekja e këto, nuk e shoh të arsyeshme për me dit arsyen sepse ne kemi qenë në vendin tonë. Mirëpo, është mirë të hulumtojë komisioni për të cilin ju përgëzoj shumë dhe ishalla ju ec mbarë, ta dimë si është bërë krimi, rasti i zotërisë Tahiri dhe shumë raste tjera të zhdukurve. Pra, vetëm me i dit arsyet ku janë njerëzit, sepse arsyet tjera... Do të thotë të zbulohen vendet se ku janë, krimi ku është bërë, me i gjet kriminelët, me i qit përpara dhe me i pa ne. Na me u ngi me ta, thjeshtë. U bënë 11 vite, e arsyeja pse janë bërë, nuk po e shoh të arsyeshme me dit pse. Ne e dimë të gjithë pse! Këtë e pata.

Besarta Vasija: Po, urdhëro zoti Tahir!

Tahir Rraci: Desha edhe diçka me shtua, pasi që na keni ftuar këtu. Unë thash edhe në fillim më parë, ju falënderoj shumë dhe ju mbështes për iniciativën që e keni marrë dhe çdo kush që e merr këtë iniciativë. Ishte në pyetje, ju tash kërkonit përgjigjet tona, direkt.. A me i fal kriminelët? Jo! Pse, jo për diçka tjetër, por krejt bota nuk është duke i falur. I përmendët ju disa shtete. Ju duhet të thoni qashtu, por sot janë kah lypen ata të Aushvicit, janë kah lypen edhe njerëz tjerë për t'u dënuar për krimet e tyre, sepse nuk dënohen krimet do të bëjnë nesër krime prapë. Kjo është një.

E dyta. Qysh me ardhur deri te zbulimi i rasteve? E cekët pak më parë fondin prej 10 milionë a 20 milionë, nuk e di sa është. Por kur e ke fondin e fortë, ai që e mbështet këtë komision dhe ta jep fondin, me të holla mund të vjen deri te gjetja sepse njerëzit me të holla tregojnë vendet ku kanë ndodhur, ata njerëz janë që punojnë në Serbi, punojnë në Kosovë. Kur iu ofron ti mjete, ai do ta zbulojë, do të thotë janë bërë këtu e këtu krime, gjenden këto kufoma këtu apo aty.

Qysh ne të flasim për t'i liruar kriminelët kur s'i kemi gjetur ende kufomat?! Mendimi im është se do ta keni mbështetjen tonë, por si do të duket komisioni, ka kohë të diskutohet prapë. Nëse e ratifikojnë parlamentet e këtyre shteteve, atëherë do të bisedojmë prapë për modalitetet e komisionit. Ju faleminderit!

Besarta Vasija: Po, Nora, urdhëroni!

Nora Ahmetaj: Shumë mirë që e cekët problemin ose konceptin e faljes. Kur është vendosur të fillojë hulumtimi për krimet e luftës dhe të themelohet ky komision ose Iniciativa – Koalicioni në mënyrë kategorike, dhe ju Bekim mundeni me më përmirësuar këtu se ndoshta e din më mirë, kanë qenë viktimat – familjarët e viktimave por edhe të gjithë ata që janë marrë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe se komisioni të quhet komision i së vërtetës dhe i gjetjes së fakteve për krimet e luftës në ish-Jugosllavi. Në asnjë mënyrë ky komision nuk do të quhet komision për amnisti ose komision për falje.

Nuk ka shumë komisione për amnisti në botë. Është vetëm ai i Afrikës së Jugut, por ai është për arsye se aty ka pasur marrëveshje, aty ka pasur marrëveshje që Komisioni për amnisti të amnistojë ata njerëz të cilët ose kërkojnë falje haptas ose të cilët japin informata pak më të vlefshme për viktimën. Mirëpo, nuk shkohet që patjetër të jetë ashtu, por ajo i mbetet viktimës të vendosë, por ky komision ka me qenë për gjetjen e fakteve dhe të së vërtetës, jo për amnisti.

Ndërkaq, është mirë që nga disa konsultime të kaluara që i kemi mbajtur në Kosovë, e mbaj mend që edhe të rinjtë dhe gratë e kanë theksuar problemin e kërimit të faljes dhe ajo mund të hyjë në mandat, e me këtë ne po kërkojmë që Serbia të kërkojë falje, ne po domi që filan – fisteki të kërkojë falje dhe kjo mundet gjithashtu me hy brenda, por këto janë krejt sugjerime që vijnë prej jush. Por, kjo puna e amnistisë është pak më e komplikuar.

Tahir Rraci: Unë desha prapë të kyçem. Nuk jemi as ne për të mos falë, por ajo pikë e fundit për mendimin tim. Unë ceka pak më parë fondet. Fondet e mëdha sot mund të bëjnë çka të donë. Ta marr vetëm një shembull. Me siguri ju i keni parë para meje këto. Unë i kam disa fotografi të njerëzve të vrarë në burgun e Dubravës kur ne s’kemi pas bukë me hëngër e lere më me fotografua një shok tonin të vrarë. Dikush i ka marrë prej të burgosurve serbë, prej atyre që kanë qenë ordinerë serbë, i kanë marrë këto fotografi dhe më besoni i ka marrë ndoshta për një shumë – shumë të vogël apo për një paqetë cigare. Kur është fondi, falja vjen më vonë. Qysh ti do të më kërkosh falje mua nëse unë nuk i kam gjetur anëtarët e familjes. Ne do të tubohemi prapë. Le të gjenden kufomat, e falja është më e fundit, për mendimin tim. Pra, është vetëm mendimi im, unë as nuk i përfaqësoj sot dhe nuk kam ardhur me përfaqësua sot as shoqatën e të burgosurve politikë, as të burgut të Dubravës por si individ që e kam përjetuar atë masakër, i shpreh vetëm mendimet e mia. Faleminderit edhe një herë, ndoshta e çova pak gjatë.

Besarta Vasija: Ju faleminderit! Dikush tjetër? Po, urdhëroni zonjë!

Emine Bytyqi: Mu këtu kur po dëgjoj fjalën për falje apo pajtim, po më duket kjo mjaft absurde. Për deri sa ndriçohet edhe rasti i fundit i të pa gjeturve, deri sa shteti serb kërkon falje publike, nuk e di se si t’ua zë goja, për shembull juve, apo kujtdo tjetër që të debatohet kërkim falja. Unë po nisem vetë prej vetes, ku unë nuk e di ku e kam anëtarin e familjes që e morën në shtëpi pa kurrfarë faji dhe të mos kam të drejtë të di, si thuhet një fjalë e urtë popullore – ku ta çaj te varri i vet se i takon këtij dheu, e të kërkoni prej meje falje, më duket diçka mjaft absurde për mua dhe besoj edhe për të gjithë anëtarët e familjes që janë të pagjetur, nuk e di si mund të pajtohen vetëm për kërkim falje. Po ne, mezi që presim bre një kriminel të dënohet dhe me pa se e mori dënimin e merituar, kurse kjo kërkim-falja po më duket diçka që nuk mund as të shprehem për vetëm kërkim falje për ne që jemi viktimë apo kriminelë që ec lirshëm dhe pa kurrfarë droje nga askush. Ju faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit! Ndoshta këtu ishte një keqkuptim i vogël. Ne, po mundohemi, që të marrim mendime nga ju se si duhet të duket ky komision. Ne i marrim përvojat edhe të vendeve të tjera dhe ne po ju tregojmë juve vendet tjera çka kanë bërë dhe çka ua merr mendja juve – a mundemi me apliku ne për shembull ndonjë përvojë të ndonjë vendi tjetër këtu te ne apo ne po kërkojmë diçka tjetër.

Puna e amnistisë që u përmend. Nuk është kërkim-falje dhe u harrua kjo punë. Po, për shembull, e kemi rastin që kemi ne shumë të zhdukur dhe ndoshta nuk po kemi asnjë mundësi të vijnë deri te gjetja e familjarëve tanë.

Nëse po del një ditë një kriminel dhe thotë – unë do të ju tregoj ku janë familjarët tuaj, por unë kërkoj diçka prej jush. Ose, mendon – me ia zvogëlu dënimin, ose të lirohet. Po, normalisht, ai kërkon diçka prej jush për me dhënë këtë informatë. Prandaj, kjo nuk do të thotë se kjo do të aplikohet këtu. Ky është një diskutim ku ne do t'i tregojmë përvojat, për shembull, si ka qenë në Afrikën e Jugut ku për shembull krimbërësi ka treguar ku janë varrezat masive ose kush i ka vra, apo kriminelët tjerë i ka zbuluar dhe pastaj ai është liruar ose i është zvogëluar dënimi. Po kjo, nuk do të thotë se ka ndodhur edhe në komisionet tjera. Absolutisht! Kjo mund të mos ndodhë kurrë këtu.

Pastaj kërkim-falja. Kërkim-falja është diçka që vjen në fund. Kërkim-falja, mund të jetë gjest politik. Për ne, do të thotë, kryesorja është të gjendet trupi i familjarëve tanë. Të gjenden varrezat masive. E se a do të dënohen kriminelët!? Po unë pyeta, do të thotë, a jeni për me i emëru, sepse ka njerëz të cilët këtu e dinë saktësisht me emër e mbiemër kush i ka vra. Ka njerëz që i kanë parë me sytë e vet kush janë ata.

Pastaj, në bazë të këtyre rekomandimeve tuaja, ekziston një trup punues prej ekspertëve të cilët në bazë të atyre rekomandimeve tuaja e krijojnë modelin – mandatin e këtij komisioni. Ne nuk po dëshirojmë ta lëshojmë në dorën e parlamenteve dhe me thënë – krijoni ju një komision dhe ata ta bëjnë një komision si u konvenon atyre. Për këtë, ne po duam të dimë nga ju, prej gojës tuaj se si doni të duket ky komision, pra në bazë të përvojave tuaja, në bazë të kërkesave dhe nevojave tuaja. Po, urdhëro, zotëri!

Isa Gashi: U prezantova edhe më parë. Jam Isa Gashi, kryeplak i katundit Pavlan. Pare jam prezantuar si kryefamiljar, tash po prezantohem si kryeplak i katundit. I kam 15 të vrarë, duke filluar prej 1 janarit që ma kanë kidnapua Veton Kelmendin, e të nesërmen e kemi gjetur të vdekur, në stom të rrugës të gjuajtur. I kam 10 që janë vra më 14 maj dhe të djegur, i kam mbledhur eshtrat e tyre – kockat e tyre si cingaret që mblidhen dhe prej të 10-ëve një kolicë nuk u mbushë, i kam varrosur. I kam edhe 3 pastaj që mu kanë vra, një më 5 qershor, tjetri më 8 qershor dhe tjetri me 10 qershor. Dhe i fundit, është vra diku më 17 – 18 qershor dhe po dihet se kush e ka vra. Pa faj e kanë vra dhe jam në gjendje me krejt katundin se ai njeri ka qenë nis e sos me mua i strehuar, i ka lënë 5 fëmijë jetimë, gjynahi i zotit. Por deri sot, disa herë kam dhënë intervista edhe në Qyshk, në Pavlan dhe në Zahaq – gazetarëve të ndryshëm dhe kurrë diçka nuk doli në shesh. Si punëtor më i madhi dhe më i miri për deri sot Tahir Dema, i pastë shpirti rahmet, u mundua boll por asnjë send nuk doli në dritë prej punës së tij dhe prej atyre. Unë nuk di se kush është ndëshkuar dhe kush është marrë në pyetje për ato punë.

Kryesisht te ne, krimet i ka bërë, lirisht mundem me thënë krim sepse janë të vrarë civilë, banorë të pafajshëm, i ka marrë shtëpia, 10 janë djegur në një shtëpi, që po them i kam marrë dhe një kolicë eshtrat dhe i kam çua prej tyre. Kanë qenë të gjithë të pafajshëm. Për këtë, askush nuk u mor në pyetje. Ne e dimë se Mija Brajeviqi ka qenë kryesori i tyre dhe Mija sot shëtit lirshëm. Unë e di që ka ardhur te unë Milosav Portiqi, Miroslav Simonoviqi i Gorazhdecit nga bajagi me lyp ushqim se o mbet pa ushqim. Më 11 maj, e më 14 jemi vra. E ka parë ku gjendemi ne të gjithë dhe e kam lutur bëju selam pleqve të Gorazhdecit, jemi tash ngushtë, mendoni se ndoshta nesër ju bini ngushtë. Dine çka jeni kah bëni e ndihmonani në këtë rast. **E pa, Iso, i Lozhanci su bili kod nas. To su rekli, ali mi im ne mozemo nista, to je ofanziva.** Çfarë ofensive? Nuk është kanë as atëherë as sot. Atij i kam thënë, ne s'jemi në front. Fronti dihet ku është. Ne jemi civilë, jemi banorë të këtij fshati dhe komshi të juaj, na ruani. **A, ne mozemo mi sa ofanzivom nista.** U vranë më 14 maj 10 të pa faj, te tanë në shtëpia të veta pa faj, janë djegë dhe asgjë s'u morr deri

sot. Jemi të zhgënjyer me intervista, për ata edhe hezitojnë shokët, sepse nuk na doli asgjë në dritë. Ishalla keni sukses. Ishalla na ndihmoni në këtë rast. Ishalla ai që punon për këtë popull, zoti i dhashtë, e bekoftë. Por po më duket se vetëm badihava po na mundoni sepse s'ka gjë. Ju uroj sukses!

Besarta Vasija: Faleminderit shumë! Dikush tjetër? Urdhëro zotëri! A mundeni me ndez mikrofonin, të lutem!

Daut Elshani:Unë pikësëpari ju falënderoj juve që na keni ftuar. Shumë bukur, dhe populli që ka ardhur. Kemi dhembje ndaj të gjithëve, të gjithë janë të vrarë, të masakruar. Unë jam një babë i dëshmorëve – 3 dëshmorë, 3 djem. Mua m'i kanë vra, i kanë gjuajtur armët dhe janë rrasë në kolonë, prej kolone na i kanë marrë dhe na i kanë mbyll në katundin Stardran, na i kanë masakrua, na i kanë vra, m'i kanë ngreh djemtë zhag me kamion dhe janë të prerë me motor të drunjëve. Atë ditë e në ditën e sodit askush nuk erdhi, qe 10 vjet me thënë ku janë këta njerëz, çka u bë me ta. Me u konstatua me Dautin apo me Hyenin, Hasanin a tjetrin. Ama, aspak!

Udhëheqësia si udhëheqësi veç në ardh të ta kërkojë një votë, se mandej asgjë. Janë duke u pasuruar disa njerëz, janë duke u pasuruar me të madhe. Po qe besa ka thënë plaku qysh moti, dikur iu mbetet në fyt. E neve, të gjithë jemi këtu të dëshmorëve, të gjithë: pasha nderin, ju falënderojmë që na keni thirrur sot, kurrfarë ndihme nuk kemi... Tash unë kam mbetur pa 3 djemtë dhe vëllain – 4. Kur të vini ju udhëheqësia, vijnë ma heqin dhimbjen pak. Thonë që ku ka ky dhimbje. E atëherë duhet me u pajtua edhe unë me atë dhembje, motër. Tahiri i juaj, një djalë e ka pasur – Tahir Ahmetaj i Zabllaçit. E di, e di i kahit është e kush është. Ai u mbet me 9 vajza dhe kur rri me të, ndeshem ne ndër veti, rrimë e bëjmë ndonjë muhabet, se s'i ka kanë kush te shtëpia. Dhe, le të tregojnë edhe këta të tjerët a u ka ardhur dikush bile me thënë a ke ujë, a ke ndonjë grimë dru, a ke ndonjë bukë, a diçka se ne kemi dhënë pak gjak. E kemi dhënë! Dhe, prapë, tek fundi, mos me pas qenë ai gjak i këtyre meshkujve tanë, vallahi as Amerika as kërkushi në këtë vend ardhë s'kish dhe kurrë më s'e kishim shkelë më këtë Kosovë, shqiptarët jo. Sepse unë kam shkua në Shkodër, më kanë çua. Atje kam jetuar nja 2-3 muaj me familje. Kur jam ardhur pas 5-6 muajve i kam gjetur meshkujt në katundin e Staradranit.

Prej udhëheqësish, prej fillimit e deri sot, s'kemi kurrfarë ndihme. Jam i pëlqimit i asaj motre, shumë-shumë dhe s'deshta me fol por me u konstatu dhe me u bashkëngjitë me atë. Edhe këtij këtu jaranit se ata të Dubravës 115 unë vetë i kam nxjerrë prej dheut dhe 255 në Pejë këtu duke i kërkuar djemtë e mi dhe tash, çka me bë, duhet me i gjet – a. E pas së mbrëmi ata i kishin pas shti në katundin e Staradranit në do varreza në Mavraj atje, i kemi gjetur të masakruar, ua kemi mbledh copat – me kitorra të druve, aty kanë qenë 15 vetë – a 16. Dhe, ju falënderoj. Mos shihni kusur se ndoshta kam diçka gabim po nëse ka diçka, mundeni ta përmirësoni. Por, kurrfarë ndihme, po mendoj, pasi nuk kam unë as ju tjerët s'keni. E ne paq dikë atje në udhëheqësi lartë, fort të ngatë se jo bash, por ne paq fort të ngatë ai të ndihmon. Ju falënderoj shumë që na keni thirr. Kaq pata. Kisha pasur qejf që ato djemve me hi e me i rregullua pak se ata janë vra si ushtarë, nuk janë vra civilë as nuk janë vra duke vjedhur as në hajni. Ata janë vra ushtarë. Sali Lajqi m'i ka përcjell, kanë shkua djemtë për Shqipëri me 12 kuaj. Ajo është e vërtetë. Sali Lajqi është gjallë. Daut Haradinaj i ka lëshuar vendimet, ushtarë 4 muaj e gjysmë janë kanë, m'i kanë fsheh dokumentet. Dikush i ka fsheh, dikush i ka gjuajt andej e këndeje e ata njerëz i dimë.

Edhe një, më falni. Ata serbë që i kanë vra djemtë e mi aty, ata kanë qenë të gjithë të komshive. Nuk kanë qenë të largët. Shumë i njohim. 12 kanë qenë aty të njohshëm. Ka pasur edhe boshnjakë, edhe shkie. Ndoshta ka pasur edhe ndonjë shqiptar, por nuk i kam njohtë. Ju falënderoj. Kaq.

Besarta Vasija: Faleminderit! Bekim, urdhëro!

Bekim Blakaj: Faleminderit, zotëri Elshani! Në fakt, gjatë debateve këtu, po i nxjerrim do ide tuajat dhe zonja Dervishaj e përmendi se ndoshta shkaktarët e krejt këtyre luftërave nuk janë aq me rëndësi sa për të mësuar të vërtetën. Edhe zotëri Elshani përmendi edhe një lloj përkrahjeje dhe ndihmë, si e quan ai.

Meqë nuk folëm në mënyrë më koncize se si janë duktë komisionet, komisioni kur të krijohet e ka një mandat me çka do të merret dhe ne të gjithë këtu u pajtuam se duhet të merret me çështjen e personave të zhdukur, me personat e vrarë dhe normalisht, aty përfshihet edhe burgu i Dubravës, sepse ata persona janë të vrarë, e disa prej tyre janë të zhdukur e kështu me radhë.

Komisioni kur ta përfundojë punën e vet, do të thotë bën hulumtime në terren, prandaj edhe ne e kemi idenë që të quhet komisioni për vërtetimin e fakteve për krime të luftës dhe krime tjera të rënda ndaj njerëzimit. Mbledh faktet dhe shkruan një raport, do të thotë i emëron si kanë ndodhur, qysh kanë ndodhur. Edhe për këtë u pajtuam se duhet të emërohet me emër ata që kanë bërë krime.

Mirëpo, në fund, gjithmonë komisioni duhet t'i ketë rekomandimet. Do të thotë del me rekomandime. Zakonisht të gjitha komisionet që janë krijuar në botë deri tash, ndër rekomandimet i kanë pas reparacioni respektivisht dëmshpërblimi për viktimat. Jo gjithmonë dëmshpërblimi është i domosdoshëm të jetë material, megjithëse gati në të gjitha komisionet përfshihet dëmshpërblimi material por mund të jetë edhe simbolik, po e zëmë ngritja e një përmendoreje, ose disa përmendoreve, apo caktimi i një date të caktuar gjatë vitit ku ajo datë ose ajo javë do t'i kushtohet viktimave. Mirëpo, gjithmonë, do të thotë komisioni del me rekomandime dhe në rend të parë vijnë rekomandimet që kanë të bëjnë me dëmshpërblim për viktimat ose për familjarët e tyre. Unë besoj se edhe KOMRA – komisioni rajonal në këtë rast do të ketë një rekomandim për këtë çështje. Dhe, meqenëse komisionin kanë me krijuar qeveritë respektivisht parlamentet, atëherë të njëjtat janë të obliguara që t'i aprovojnë ato rekomandime dhe me i zbatua në jetë. Do të thotë me ua dhënë dëmshpërblimin familjarëve ose vetë viktimave, kur është fjala për dhunime dhe për çështje tjera. Do të thotë gjithmonë do të kihet parasysh që komisionet të nxjerrin një rekomandim. Kaq, dhe nuk do ta zgjas më shumë por ju kisha lutur të gjithëve të fokusoheni në mandatin e komisionit, çka mendoni ju, me cilat çështje duhet ai të merret, pastaj struktura e komisionit e kështu me radhë. Faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit! Urdhëroni, kush do me marrë fjalën? Urdhëroni, zotëri!

Avdyl Hiseni: Jam Avdyl Hiseni, nga fshati Zahaq. Ne tre vëllezërit i kemi 6 djem të vrarë. Një nuk është gjet, sipas analizave. Vëllai i madh e ka një, unë e kam pas qatë dhe një më ka shkua, vëllai i tretë 4. Mirëpo, që e ceku edhe ai i Pavlanit, ne na kanë vra komshitë. Nuk na kanë vra neve prej Serbisë, sepse s'e ka dit ku e kam shtëpinë as ku e kam vendin. Prej kolone na i kanë marrë djemtë, 18 vetë që na kanë qit prej shtëpive dhe na i kanë marrë 19 vetë. Prej atyre 19 vetëve sipas analizave janë gjet 15 dhe 4 vetë nuk janë gjet kurrë sot e atë ditë. Në një vend kanë qenë. Ne e dimë edhe ku i kanë pushkatuar kur jemi kthye prej kolone dhe me sy të mi i kam pa në kanal. Natën janë shkua dhe i kanë heq prej aty, i kemi gjetur në Ruhot, do të thotë në Murriz aty, ne jse sipas analizave

se s'i kemi gjet. Në Ruhot i kemi gjet. Një nuk është i gjetur, por 4 janë prej atij grupi. Ne po kërkojmë prej këtyre komshive tanë që janë me emra të cekur që këta me ardhë e ne me na i gjet djemtë ku janë, pse na kanë vra dhe atëherë ne mundemi me u marrë vesh ndër veti. Për kështu, vetëm ju mund të merreni vesh, ne nuk mundemi. Se sot ne, anëtarë të familjes që jemi, 14 fëmijë na i kanë lënë djemtë tanë, 6 nuse të reja. Nuk është kollaj me i përballua të gjithë ata fëmijë, ato gra. Të gjitha janë me trauma. Fëmijët që e kanë përballuar luftën po ashtu janë me trauma. Kush brenda dere, nuk vjen në kapixhik me më cokat, e që e tha ky, vetëm për vota kur të vijmë sepse kurrë në atë vend s'më ka ardhur kush, me dit çka je, a ke, a nuk ke, a je gjallë. Ne jemi mbetur 3 pleq sot. Më i madhi fëmijë i imi sivjet ka shkuar në shkollë të mesme, në klasën 10. Krejt tjerët, prush janë deri në klasën e pestë. Kjo është një marri e madhe, së pari për qeverinë tonë dhe në tjetrën anë për ata komshitë që kanë qenë ksajde për rreth sepse ata na i kanë pru neve serbët e Serbisë dhe neve na kanë pru në këtë ditë, sepse ata nuk na i kanë dit shtëpitë dhe nuk na kanë njohtë ne hiq. Më tepër nuk kam çka të them, ju faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit! Dikush tjetër? Po urdhëro!

Tahir Alimehaj: Quhem Tahir Alimehaj, vij nga fshati Lubeniq. Unë i kam 6 anëtarë të vrrarë të familjes, babën, nënën, vëllai, gjyshen, tezen, djalin e tezës. Ata janë vra në bjeshkët e Lubeniqit, 6 vetë. Po unë nuk e kam dit se nuk kam qenë aty, domethënë jam dal në Shqipëri, se kam qenë fëmijë atëherë, jam dalë me do të katundit dhe pasi jam kthye, por para se jam kthye, më kanë lajmërua se janë vra, po unë nuk e kam dit. Një i Lubeniqit, e tash s'po ia cek emrin si e ka, por në bazë të tij unë i kam gjetur vetëm 4 të familjes, e babën e nënën s'i kam gjet. Nuk e di sot e asaj dite asgjë për ta dhe nuk kam kurrfarë të dhëne. Dhe për këta të katërtit i kam marrë e i kam varrosur qashtu siç kanë qenë, të djegur në stan atje, në bjeshkë dhe i kam varrosur. E i ka qe një vit e gjysmë që i kemi nxjerrë për me bë obduksionin e tyre. S'e di se a janë këta a s'janë, veç në bazë të fjalëve, sot një vjet e diçka, ende nuk më është kthyer përgjigja për ata eshtra a janë sigurt a s'janë. Dhe tash është hera e fundit që kam dhënë gjak, qe tri herë kam dhënë, por tash është hera e fundit që në verë kam dhënë gjak dhe s'mu ka kthyer përgjigje nga zyra në Prishtinë për të zhdukurit. Pra, nuk kam përgjigje a janë këta të familjes a s'janë. Do të thotë për katër është fjala, e unë i kam 6 dhe nuk e di saktë a janë a s'janë. 4 i kam varrosur por nuk e di sigurt a janë këta apo s'janë ata të varrosurit nga familja ime. Ka pata. Faleminderit! Kisha pas qejf me dit, sepse ende nuk ki sepse s'kam kurrfarë përgjigjeje për këtë.

Besarta Vasija: Faleminderit! Dikush tjetër? Atëherë, unë kam një pyetje tjetër për ju. Në komisione të ndryshme, në vende të ndryshme, emërohen komisionarë në mënyra të ndryshme. Diku kjo bëhet publike, diku emërohen ose nga presidenti ose shoqëria civile. Unë desha të ju pyes juve: çka mendoni ju, nëse vjen deri te themelimi i këtij komisioni, kush ishte dashur të përfshihet në këtë komision, a ishte dashur edhe viktimat të jenë pjesë e këtij komisioni, apo çka mendoni, a ishte dashur ta ketë shoqëria civile një përfaqësues aty. Urdhëroni, zotëri!

Emine Bytyqi: Po unë, jam e mendimit se duhet me i përfaqësuar edhe familjarët e viktimave të pagjeturit, por më parë do të ishte e udhës që të merret shteti me këtë dhe sidomos një delegacion i qeverisë – i atyre familjarëve të pa gjetur të viktimave po se po, por edhe shteti duhet në rend të parë se tash po thonë jemi bërë shtet dhe çon peshë pak më të madhe shteti dhe sidomos të ndonjë familjari të pa gjetur apo të viktimave.

Besarta Vasija: Mirë! Atëherë, nëse ju keni dyshime për shembull se shteti deri tash nuk ka bërë asgjë.

Emine Bytyqi: Po nuk kam dyshime, por nuk ka bërë deri më tash asgjë. Qe 11 vite asgjë, dhe se nuk po shoh diçka pozitive që ka bërë, sepse po të kishte bërë, por nuk ka bërë se qe 11 vite nuk janë ndriçuar rastet dhe për atë mendoj se shteti nuk ka bërë asgjë, e tash e pas, ishalla, meqë u bë shtet, ndoshta po bëhet diçka më mirë, por pak mendoj.

Po edhe pak desha të kyçem për atë që the, Besarta, se nëse një kriminel afron diçka, për shembull për zbardhjen e rastit të fshatit tim dhe tregon se janë këtu, ndoshta vjen në konsiderim me e falë. Po unë së pari kisha me pyet atë, nëse vjen në shprehje, se nuk besoj hiq që e tregon rastin, po ta zëmë se do ta tregojë rastin se ku janë familjarët apo fshatarët e mi – 18, ia kisha bërë pyetjen së pari: pse i vrave. Apo pse i kanë vra, e di, se kanë pasur urrejtjen në gjak shqiptari gjithmonë, po ku ishte qe 11 vite e që nuk e tregove dhe pas 11 viteve të erdhi rasti me më tregua. Dhe, përpara ta kisha bërë pyetjen ty, së pari, që e the atë fjalën nëse afron kriminelin diçka, çka i kishte afria. Nuk e di çka i kisha afria atij, por drejtësia ndoshta ishte marrë pak a shumë me të e u në nuk di, nuk di me u shpreh se çka i kisha afria atij.

Besarta Vasija: Faleminderit! Zotëri, urdhëroni!

Sahit Gjocaj: Quhem Sahit Gjocaj dhe ju përsëndes. Jam anëtar i familjeve të zhdukur nga fshati Rashiq. I përkrah mendimet e të gjithëve. Po kur ishte në pyetje formimi i komisioneve se kush do të caktohet dhe merr pjesë në formime të komisionit, unë kisha thënë se të gjithë ne sa jemi këtu jemi përfaqësues të familjeve të zhdukur, të vrarë dhe të viktimave, kështu që të koordinohen dhe të merren nga këta anëtarë të familjarëve por edhe nga shoqëria civile pse jo, sepse edhe ata mund të kenë mendime të ndryshme ose përkrahje më të madhe do të ketë edhe nga shoqëria civile.

Kur ishte pyetja për këtë, te kriminelët për falje ose për lehtësime të tyre nëse ne vijmë deri te gjurmët, edhe unë e përkrah motrën time këtu që e kam afër se nuk di as vetë se si do të falet ai mëkat i tyre ku qe 11 vite... nuk është e mundshme që nuk dihet skenari i këtyre veprave makabre që ndodhën në trojet tona po le t'i gjykojë drejtësia dhe pushteti aktual i Kosovës. Ju faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit! Urdhëroni!

Junuz Gutic:

Besarta Vasija: Faleminderit! Urdhëroni zotëri!

Isa Gashi: Desha si shkurt, katundarçe. Thonë se e ka bërë llogarinë pa hunxhinë. Nëse ju mendoni se qeveria, kjo që qe 10 vjet, 11 vjet nuk ndërmori asgjë, unë pikë uzdaje në të nuk kam. Nëse nuk janë familjarët në atë komision, e di që nuk kemi bërë asgjë. Ju faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit! Dikush tjetër? Po, urdhëroni zotëri!

Idriz Fetahi: Idriz Fetahi, ish i burgosur. Nuk jam i burgut të Dubravës as i Pejës, jam i burgut të Gjakovës, të Prishtinës, të Mitrovicës dhe së fundi të burgut të Skenderajt që kanë qenë duke na pru për Pejë dhe kemi ikur. Ju përgëzoj për këtë komision. Ju mbështesim për këtë komision. Kam qenë shumë nëpër burgje të Kosovës gjatë luftës si ish i burgosur. Më së shumti më ka çuditur fakti sepse kam takuar edhe shqiptarë nëpër burgje, jo si të burgosur por në uniformë dhe më së shumti kam takuar edhe boshnjakë, sidomos prej Vitimirice, njëfarë Sadria që kam dëshirë me u takua me të dhe me një të Istogut tjetër. Këtu është në pyetje se ne po flasim, e mua më vjen keq sepse këta kanë

humbur anëtarë të familjes, unë kam qenë i burgosur por është tjetra se kisha pas dëshirë të merrem më së shumti me persona të pa gjetur se me do punë tjera. Faleminderit!

Besarta Vasija: Urdhëroni, Fatmire!

Fatmire Dervishaj: Shumë më pëlqeu ky që foli dhe që pat rastin me tregua edhe me emër. Kjo është ajo që ne po kërkojmë prej secilit nga një deklaratë dhe secili do ta thotë nga një dëshmi që pastaj komisioni të ecë përpara, do të thotë me ia arritur qëllimit. Mua shumë pëlqej dhe hallall që ke mbajtur në mend së paku emrin se ka njerëz këtu me trauma që sikur të kthehemi 10 vite pas ndoshta edhe s'mundemi me i kujtua shumë gjëra. E di se vetëm që kam vuajtur shumë me fëmijë dhe asgjë më shumë.

Idriz Fetahi: Është në pyetje se me harrua është zor, sepse e kam një shenjë këtu të, prej tij në burgun e Gjakovës e për atë edhe nuk mundem me harrua, sepse sa herë që dal te pasqyra për t'u rruar, do të thotë e shoh vijën këtu prej tij. Për atë edhe nuk e harroj. Faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit shumë! Kjo e tregon se është një kërkesë imediate për një komision rajonal, i cili do të dalë dhe do të hulumtojë. Neve na duhen faktet. Na duhen argumentet dhe jo të flasim – ka ndodhë, janë vra këtu kaq, e disa veta i kanë vra. Po tjetra, kjo na duhet që ne t'i dimë kriminelët me emër dhe mos të gjykojmë për një popull në përgjithësi. Prej secilit ne mund të gjejmë se kush ka qenë e çka ka qenë. Mjaft është manipuluar me emrin e viktimave dhe secili popull e ka konsideruar veten si viktimë dhe i ka mbyll sytë ndaj popullit tjetër. Prandaj, ne na duhen fakte dhe të flasim me fakte, sepse nuk mund të jetë komplet një popull fajtor. Nuk mund të jemi të gjithë fajtorë. Prandaj, unë po mendoj se është shumë me rëndësi që ky komision të themelohet sa më shpejt. Po ashtu mendoj se ne kemi nevojë shumë për ndihmën tuaj, do të thotë edhe për mbështetjen e juaj. Nora, urdhëro!

Nora Ahmetaj: Unë e kam një pyetje për ju të gjithë. Po e tregoj një rast, për shembull. Ju e dini çka ka ndodhur në Luftën e Dytë Botërore dhe vrasja e 6 milionë hebrenjve në Holokaustin në Gjermani, por edhe në krejt Evropën prej forcave nazifashiste. Në Izrael, më duket më 17 maj, është kjo me ligj dhe me dekret, momenti kur është themeluar shteti i Izraelit dhe është vendosur që ajo ditë, që ata e quajnë dita e kujtimit, e viktimave dhe për shkak të 6 milionë hebrenjve që janë vra vetëm në kampet nazifashiste, përveç shumë memorialëve tjera që i kanë, e kanë një kohë të caktuar kur bien sirenat dhe gjithçka në atë moment kur bien sirenat për dy-tre minuta gjithçka stopohet, edhe veturat në rrugë, edhe njerëzit dhe ai është momenti kur secili është i obligueshëm ta bëjë, sepse gjithçka ndalet, ndalet edhe ora dhe gjithçka si përkujtim për viktimat e Holokaustit.

Shumë shtete në botë, apo disa shtete, po më duket edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës po edhe disa vende tjera perëndimore po edhe disa shtete pak të zhvilluara e kanë të caktuar një ditë për viktimat. Ajo ditë caktohet me iniciativat e qeverive të shteteve, sepse ajo duhet me u përkujtua viktimat dhe gjaku e sakrificat e popullit, dhe duhet të caktohet me ligj apo me dekret. Në Kosovë nuk ka diçka të tillë. Në Kosovë janë iniciativat ose të qyteteve ose të familjeve të dëshmorëve, por qeveritë tona nuk e kanë marrë atë iniciativë për me caktua një ditë – dita e përkujtimit të viktimave, të gjitha viktimave në Kosovë, pa marrë parasysh afatin kohor. Mua po më intereson mendimi juaj rreth kësaj sepse edhe kjo iniciativë, nëse propozohet, edhe pse kjo mundet dhe s'mundet me qenë pjesë e komisionit mirëpo këtë kishin mund edhe organizatat joqeveritare këtë iniciativë ta fillojnë, me shty dhe me bë presion te qeveria dhe qeveria vetë nuk ma merr mendja se kishte me pas ndonjë problem për ta pranuar. Mirëpo, unë nuk e kam të qartë pse deri

tash nuk është bërë. Për këtë, bash po më intereson mendimi jua, a mendoni se kishte dashur me qenë një ditë përkujtimi për viktimat ku atë ditë krejt Kosova, absolutisht, i madh e i vogël, edhe fëmijët në orën e parë të mësimi, studentët do tua kushtonin viktimave, por jo ajo të bëhet në mënyrë sporadike ose prej kohës në kohë, prej individëve apo eventualisht të familjarëve.

Besarta Vasija: Urdhëro, zotëri Tahir!

Tahir Rraci: Desha të kyçem. Ju pyetët, pse s'e ka bërë qeveria. Në pritsh me bë qeveria atë ditë sikur e kanë bërë që u cek më herët, nuk bëhet kurrë. 10 vite pas lute, krejt këtu janë familjarë të dëshmorëve, invalidë të luftës. Sot e pas 10 vite marrin një ndihmë prej shteti, të madhe apo të vogël, nuk e akuzoj shtetin pse s'është më e madhe se ndoshta s'i kanë të ardhurat, por ajo është ndihmë. Unë mundem me ta falë këtë, por nesër ta ndali. Ende është ligji i pa aprovuar në Parlamentin e Kosovës, i vlerave të luftës. S'po i ceku radhazi, sepse të gjithë i dini. Pse është bërë kjo? Sepse Qeveria jonë ka presion prej ndërkombëtarëve. Mos të thirret në luftë, të thirret në konflikt. Konflikt kemi unë e ti tash, ma shtynë ma këndeje apo më andej, kurse lufta është luftë. Duhet këtë ta dinë udhëheqësia, po edhe ky komision nëse formohet. Në Kosovë ka pasur luftë, nuk ka konflikt. Duhet të sqarohen gjërat. Konflikti është konflikt, lufta është luftë. Ne me Serbinë kemi pasur luftë. Ishte fjala për falje. A na duhet të shkojmë e t'i kërkojmë falje Serbisë? Ajo së pari duhet t'i pranojë krimet që i ka bërë dhe atëherë mbetet në nderin tonë dhe ndërgjegjen tonë çfarë do të marrim ne në hapin tjetër, por nuk varet hapi prej neve dhe ne jemi hapi i dytë. Hapi i parë është ai i Serbisë. Ajo ka bërë krimet, ajo duhet të kërkojë falje publike. Jo del një serb, thotë, unë po kërkoj falje. Jo. Shteti serb duhet të kërkojë falje. Ne duhet ta marrim hapin tjetër. Në prishim qeverinë s'marrim asnjë send. Mësa kemi marrë deri sot. As s'është ligji i aprovuar në parlament, as nuk kanë caktuar datë për viktimat të luftës, as nuk kanë me i caktua sepse frikohen mos po hiqen prej foteleve. Ju faleminderit!

Besarta Vasija: Faleminderit! Dikush tjetër? Po, urdhëroni zotëri!

Avdyl Hiseni: Ti e ceke pak më herët që këta kriminelët me i cek me emër, a ishte ashtu, apo jo. Unë po t'i ceku me emër kriminelët, por ne i kemi cekur qe 100 herë këta kriminelë për të drejtën... kush ka ardhur me marrë intervistë dhe kush ka qenë. Kërr kush s'ka marrë në pyetje, kurrkush nuk i ka ndjekë. Ata sot sillen nëpër Serbi, në Mal të Zi. E për këtë, në daç unë po t'i ceku prapë dhe që tash se ata na i kanë marrë djemtë dhe ata na kanë pri përpara në kolonë deri na kanë çua në grykën e Rozhajës dhe në grykën e Rozhajës na kanë kthye, kur na kanë kthye, djemtë i kemi gjet në kanal. Unë ata po i lypi, nuk po e lypi as qeverinë, por qeveria duhet me i pru ata sepse unë nuk mund të shkojë në Serbi i me i marrë ata. E për këtë e kam dhe me dashtë me i cek po i ceku. Mija Brajevijq, është i pari që e ka bërë masakrën më të madhe në djemtë tanë. Është Vujo Çetkovijq - 2. Është Sillobo Marjanovijq - 3, Milisav Marjanovijq - 4, dhe komandiri i policisë së Kliçinës Bërnovijqi. Pesë vetë janë këta që na kanë pri përpara kolonës, vetë komandiri i Kliçinës me këta komshitë tanë, djemtë na i kanë marrë, na i kanë zbrit, tjerët a kanë qenë ushtarë të maskuar, ata s'mund t'i njoh, a këta na kanë pri kolonën deri... Na kanë plaçkitë, na kanë rrah, na kanë sakatua deri na kanë çua atje dhe kur na kanë çua: kthehuni në shtëpitë tuaja. E për këtë unë po them, kriminelët ju me i gjet, me na i pru këtu. Tuk jeni ardhur për këtë, lypni. Tjetër nuk kam çka, ju faleminderit!

Besarta Vasija: Zonja Fatmire e pati edhe një pyetje, dhe pastaj ju.

Fatmire Dervishaj: Zotëri Avdyli! Deri më sot çka kemi cekur ne, që kemi dhënë deklarata, ti, unë, ai tjetri, ne u kemi dhënë shtypit se cilët njerëz kanë përfituar prej neve, ndoshta edhe sot janë të ngritur në kurrizin tonë.. Kjo është KOMRA, kjo është që ne po e lypim. Ti sot mirë e ceke emrin. Këta nuk përfitojnë, këta donë me shkua në mënyrën më të mirë që shumë shtete e kanë pas, kurse ne nuk e kemi pas asnjëherë. Deri më sot çka ke folur, ke folur për shtyp. Unë, ai e tjetri e tjetri, për televizion. Kjo është tjetër gjë për çka jemi ne këtu sot.

Këtu po kërkojnë ti me deklaru, unë me deklaru, këta me mbledh fakte, me i përkrah ne këta dhe kur të na thirrin ne qenë përkrahës të tyre. Faleminderit!

Avdyll Hiseni: Unë jam plotësisht përkrahës me këtë shoqatën që kanë ardhur dhe i falënderoj dhe i gjithë ky publik, të gjithë jemi ardhur për këtë. Nëse ju ecni, nëse ju na drejtoni, nëse ju mundeni me bë diçka, ne jemi të pajtimit të gjithë. S'besoj që asnjë nuk është i pajtimit. Vetëm te falja mos të na vjen. Te falja, është e fundit. Tjetër nuk po di çka me thënë.

Besarta Vasija: Urdhëro, Bekim!

Bekim Blakaj: Unë dua t'i falënderoj të gjithë ata që e morën fjalën dhe kontribuan. Falënderoj zonjën Dervishaj edhe për sqarime të ndryshme. Ne e dimë që numri i madh i organizatave të ndryshme që merren me të drejtat e njeriut po edhe gazetarët sikur që i përmendi zonja Dervishaj, i kanë kontaktuar, kanë marrë intervista dhe ju më nuk i keni parë ata e një ndër ta jam edhe unë. Mirëpo, unë për fat të mirë e kam marrë një lap-top këtu dhe të gjitha të dhënat që i kemi mbledh te familjet tuaja, te ju, me vëllain e zotit Hisenaj kam biseduar, vëllai i cili i ka 4 djem. Katër, katër! Me të kam biseduar dhe mundem. Po! Do të thotë kam biseduar, por ato të dhënat për idenë e organizatës time tash është se do të publikohen në libër. E përmenda shkurtimisht sot para dite, sepse nuk domi të lejojmë të harrohen ata njerëz, edhe për gjenerata të reja.

Tash ju që përmendët me i sjell kriminelët këtu. Komisioni, për fat të keq, nuk mund të ketë atë mandat që me i arrestuar njerëzit, me i futë në burg. Ky është mandat i gjykatave. Do të thotë, komisioni nuk i zëvendëson gjykatat. Gjykatat duhet të vazhdojnë punën e tyre por në mënyrë shumë më intensive. Një mënyrë komisioni mund t'i ndihmojë gjykatat dhe prokuroritë sepse ia bie faktet me raport të vetin dhe i emëron ata kryerësit e veprave. Çka nuk folëm sot këtu, edhe pse u përmend disa herë, por nuk diskutuam, qysh me Komisionin e Afrikës së Jugut është futur një praktikë në punën e komisioneve me u dëgjua viktimat, që quhet: dëgjim publik. Do të thotë vjen dëshmitari para komisionit dhe tregon krejt çka i ka ndodhur. Unë ende nuk mundem ta di si është disponimi në mesin tuaj, të familjarëve. Do të thotë, a kishit pranua që të dilni para komisionit dhe të tregoni se çka ka ndodhur, sepse ajo është dëshmia më valide. Komisioni e merr atë si të mirëqenë, nëse është dëshmia valide. Do të thotë, desha me bë pyetje se a mundet komisioni të llogaritë në bashkëpunim me viktimat në mënyrë që ata t'i dhënë dëshmitë para komisionit.

Besarta Vasija: Ju lutem, mikrofonin dhe prezantohuni.

Avdyll Hiseni: Kur të duash për ata, në daç vij ta japi ku të duash, ndoshta urdhëro te shtëpia, atje më mirë ta japi, po edhe ta jap një kafe dhe më i lirë jam të flas dhe të gjitha tjerat. Kur të duash, në daç ty, në daç në Gjykatë të Hagës atje dhe mos t'i dhënsha të gjitha këto para të gjithëve, çka të duash ke. Dhe, tjetër kush s'mi ka marrë vetëm këta që ua përmenda me emër. Komandiri i policisë ka pri përpara, kolona përmbas, djemtë na i kanë vra në rrugë. 19 vetë në kanal kanë qenë. Prej 19 vetëve sot nuk janë, gjashtë janë

gjet, tjerët nuk janë gjet, sipas analizave. Dhe kur jemi kthye, i kemi gjetur djemtë në kanal. Unë vetë i pari kam kërcye dhe i kam gjet djemtë në kanal dhe jam avit te djali im, me këqyrë ku është se i imi është... edhe i vëllait po, por i imi më fort m'u dhimbtë. Kur e kam pa, kam piskatë. S'kam mund me u ndal më. Atëherë, ka krisë automati, largohuni prej aty se u vrasim të gjithëve dhe kemi ikur kemi ndej në luginave deri sa ka mbarua lufta dhe më s'kemi guxuar të shkojmë në shtëpitë tona, nëpër livadhe, nëpër luginave, kah kemi mund. Dhe, për këtë unë jam me të dhënë dëshminë si të duash dhe jo vetëm unë por i gjithë katundi këto fjalë kanë me t'i dhënë, sepse e kanë përjetuar atë, çka kemi hekë, me rrahje, me vrasje, me masakra, e vetmja është - te morali - nuk mundem me thënë. Jo. A s'na kanë lënë ata majmunët që na i morën fëmijët e djemtë, apo këtë mundem me thënë, tjetër nuk mundem me thënë. Atë çka nuk e kanë bërë, nuk mund ta them. E këto tjerat, të gjitha na i kanë bë. E për ata, ti kur të duash, për dëshmi urdhëroni gjithsecili është i aftë me dhënë për të vetin këtu sepse të gjithë jemi për këtë. Urdhëro kur të duash, ti vjen te vëllai, ne jemi bashkë, kërkome mua se ai vëllai më pak është i arsimuar, në bujqësi gjithë punon dhe është pa qejf tash. Urdhëro te unë, në shtëpinë time, kam me ta dhënë intervistën si më së miri. Dhe, qysh ka qenë, e jo qysh duash. Ju faleminderit, tjetër nuk kam asgjë.

Besarta Vasija: Ju faleminderit! Tjetër kush, urdhëroni, kush e do ta marrë fjalën? Urdhëroni, zonjë!

Muniba Rastuder:

Bekim Blakaj: Në këtë moment, më së miri është do të thotë lajmërimi në polici dhe tërë kohën të kërkohet prej tyre që të vazhdoen hetimet, mos të ndërpriten dhe jo të kërkohet prej tyre llogaridhënie - çka ka ndodhur me rastin tuaj. Gjithsesi që secili njeri i ka të drejtat e barabarta para ligjit dhe janë të njëjtë.

Besarta Vasija: Urdhëroni, dikush tjetër? Urdhëro, zotëri Zaim!

Zaim Elezi:

Besarta Vasija: Faleminderit! Urdhëroni! Bekim?

Bekim Blakaj: Unë duke iu falënderuar zotëri Elezi në sugjerimin e tij se kush duhet të jetë komisionar në komision... Mund të them se shumica prej jush nuk keni marrë pjesë në konsultimet paraprake, që për fat të keq nuk mundemi me i organizuar aq shpesh dhe aq të mëdha që t'i kemi gjithmonë. Mirëpo, përveç konsultimeve që i bëjmë me familjarët e viktimave, familjarët e dëshmorëve, invalidët e luftës, shoqatat e ndryshme të dala nga lufta, ne organizojmë konsultime edhe me grupe tjera të njerëzve, siç janë të rinjtë, siç janë historianët, siç janë artistët, gazetarët, me rrjetin e grave, me grupet e grave në mënyrë që me marrë edhe prej tyre ide, sepse secili prej perspektivës së vet mund t'i japë idetë se si duhet të jetë mandati i komisionit dhe kështu me radhë.

Ideja është që edhe në komision të marrin pjesë njerëzit e profileve të ndryshme, kuptohet edhe familjarët e viktimave, ndonjë përfaqësues e kështu me radhë, prej shoqërisë civile sigurisht, mirëpo edhe profesionistë të profesioneve të ndryshme, pse jo psikologë, pse jo historianë ose të tillë. Do të thotë parashihet që të jetë përbërja e komisionit më e gjerë, me njerëz të profileve të ndryshme. Mirëpo, emëruesi i përbashkët i të gjithëve është që të jenë persona kredibilë dhe të cilët e kanë një të kaluar të pastër, të cilët i përkrah populli dhe beson në ta. Kaq.

Besarta Vasija: Faleminderit, Bekim! Dikush tjetër?

Përveç mandatit të komisionit duhet të përfshihet edhe periudha cilën periudhë do ta hulumtojë komisioni. Periudha të cilën do ta hulumtojë është prej vitit 1991 deri në vitin 200, dhe a duhet të hulumtoj të gjitha krimet e luftës gjatë këtyre viteve.

Unë ju tregova se ka pasur raste ku pjesëmarrës të ndryshëm kanë propozuar që ndoshta të bëhet hulumtimi për kohë edhe më herët për raste tjera.. Çka mendoni, ju. Ka pasur edhe pjesëmarrës serbë, që kanë dashur për shembull të përfshihet edhe viti 2004. Çka mendoni a pajtoheni me këtë që prej vitit 1991 e deri në vitin 2001 duhet të përfshihen të gjitha krimet, apo edhe më shumë.

Isa Gashi: Unë jam për ata që të gjitha këto krime që janë bërë, prej 1990 e deri në 1999 me u marrë ju. E këto që janë bërë më pastaj, për këtë është qeveria, janë policia, janë gjyqet e tjera dhe ata do të merren me to se është bërë gjatë mandatit të tyre. E për këto, që kemi hekë keq, e kemi ndejt, sikur që tha zotëria luginave, kam ndej 4 muaj ditë me 20 anëtarë, për këtë duhet të merremi vesh që tash, do të thotë me ju. Kaq unë pata.

Besarta Vasija: Urdhëro, Veton!

Veton Mujaj: Vetëm desha me cek se kur është përfshirë kjo periudha deri në vitin 2001, nuk është përfshirë për konfliktin në Kosovë por është përfshirë për shkak të konfliktit në Maqedoni. Do të thotë 1991 është përdorur për Kroaci, e pastaj 1992-1995 për Bosnjë, deri në 1999 për Kosovën, 2001-ta me përfshi edhe luftën në Maqedoni. Domethënë nuk është puna e rasteve që kanë ndodhur pas vendosjes së qeverisë.

Isa Gashi: Për atë mendova, nuk mendova për Maqedoninë. Maqedonia i ka ata të vetë dhe le ta jep të veten.

Veton Mujaj: Po vetëm desha të them që 1999 që merret me Kosovën, të jetë përpara, deri në 1999. Kurse 2001 është për Maqedoninë, nuk është direkt për ne. Mirëpo, kryesisht është për krejt rastet që kanë ndodhur në këtë periudhë.

Besarta Vasija: Po, urdhëroni!

Emine Bytyqi: Unë pajtohem me këtë periudhë kohore, është e mirë dhe pajtohem me të. Do të thotë prej 1991 deri në 2001, është mirë dhe pajtohem me këtë.

Besarta Vasija: Po, Bekim!

Bekim Blakaj: Në fakt, unë pata pyetjen për zotëri Isa Gashi, që përmendi diçka që nuk është përmend ende deri tash, dhe po dua të jam i sigurt se a ka menduar në atë. I ke përmendur edhe izolimet më herët. Kjo ka të bëjë me atë periudhën pas 1981 ku disa familje janë izoluar, a po, a është kjo. Do të thotë kjo është një shkelje e të drejtave të njeriut.

Isa Gashi: Edhe ajo ka qenë një periudhë mjaft e vështirë për ne dhe kanë qenë edhe izolimet, por plus edhe depërtimet prej pune, që janë larguar prej pune. Edhe ajo ka qenë një lloj dhune për popullin tonë.

Bekim Blakaj: Nëse më lejoni, ju kisha marr edhe një minutë kohë, jo më shumë, sepse e keni përmendur me të vërtetë një diçka të re, që askush s'e ka përmendur deri tash. Edhe kjo, është shkelje e të drejtave të njeriut. Do të thotë ky është propozimi yt për me u futë në punën të komisionit dhe me u hulumtuar këto raste të izolimeve. Faleminderit shumë për këtë sugjerim.

Mirëpo, kisha me thënë edhe diçka, nëse më lejoni, krejt shkurtimisht, në bazë të përvojës së komisioneve tjera. Zakonisht komisionet krijohen për një mandat të shkurtër kohore dhe maksimumi është 3 vjet, plus 6 muaj për përpilimin e raportit që do të publikohet pastaj. Është treguar se, nëse komisioni shqyrton shumë shkelje: zhdukjet, vrasjet, dhunimet, djegiet, deportimet, izolimet që po i përmendni ju, atëherë komisioni e ka

shumë më vështirë t'i mbledhë të gjitha këto gjëra dhe të dalë me një raport, sepse i zgjerohet, sikur thonë te ne, kosishtja, do të thotë i hapet kosishtja dhe ka më shumë punë. Mirëpo, në disa vende, komisioni kur e ka krye punën ka dalë me raport, në rekomandime të veta e ka prurë një rekomandim që të krijohet një trup tjetër zyrtar, qoftë komision apo si do që të quhet, i cili duhet të merret me një çështje specifike. Për shembull në këtë rast që përmendët ju, komisioni kur ta kryejë punën, nëse s'merret me izolime, mundet me thënë në ato rekomandimet e veta – duhet me u krijuar një komision i posaçëm i cili do të merret me çështjen e familjeve të izoluara gjatë viteve të 80-ta, ose për shkeljet tjera, sikur që e thoni ju Veton, helmimi ose diçka të tillë. Faleminderit!

Besarta Vasija: Po, urdhëro, zotëri!

Avdyl Hiseni: Gjatë luftës, ditën e parë kur kemi bërë me ikë, nuk na kanë lënë të ikim. Ne, të Zahaqit, Palvanit, të Qyshkut. Tri katunde kemi qenë të izoluara, s'kemi mund të dalim askund në oborr, as në sokak, as në rrugë dhe askund prej tyre. Vetëm na kanë thënë, mbylluni brenda, mos gaboni të dilni përjashta, UÇK mos leni brenda dhe s'ka me ju nguc askush. Ne të ngratit, pa bukë, pa ujë, nuk guxonim të dalim askund, shumë kemi hekë. Dhe qe e ceku edhe ky dhe së fundi, kur na i morën djemtë, na qitën në luginave krejt trap dhe ia nisën me na i djegë edhe shtëpitë të gjitha, na bënë rrafsh me tokë dhe në luginave dhe ditën e mirë, ata për Serbi e ne së fundi dolëm pa djem, dolëm nëpër shtëpia, të hekun keq, dikush i sëmurë, dikush gjytyrym, dikush traumë, dikujt i ka humb djali. Shyqyr që jemi ardhur mendsh deri diku, sepse, çka kemi përjetuar ne – tri katunde që kemi qenë, të rrethuar s'kemi mund të ikim askund dhe vetëm brenda na kanë lënë, veç na e dimë ta tregojmë atë. Tjetërkush nuk di. Ata u endshin gjithë natën e lume, gjithë ditën, ne vetëm u ruanim, luginave, malit, therrave, a po na hyjnë tash me na vra me rob e fëmijë dhe çka po na bëjnë, një zot e dinte. Sa na qitnin, na tubonin të gjithëve, sa na shtinin brenda dhe propë kthehuni, askush s'ka me ju ngucë, qitni arme se askush s'ka me ju nguc deri më së fundi kur e shpërndanë krejt Kosovën na u gjuan ne tri katundeve dhe i kanë vra 74 vetë prej Qyshku e deri që janë dalë në Zahaq. Qe ku është shoku! Ju faleminderit, tjetër send nuk kam.

Besarta Vasija: Faleminderit! Nora, a deshët diçka?

Nora Ahmetaj: Vetëm do ta them mendimin tim, për zotëri kryeplakut. Te format e dhunës të cilat ishte dashur me i përfshi në përpilimin e mandatit për komision, ka shumë forma të dhunës dhe është diskutuar dhe në literaturën e përvojave të shteteve të tjera thuhet se janë shumë të suksesshme kur puna e komisionit kryhet brenda 3 vjetëve dhe unë thash është shumë punë e mundimshme, duhet punuar në mënyrë shumë intensive. Mirëpo, kohëzgjatja dhe periudha historike e cila merret në kontekstin e një shteti – kur për shembull një regjim e ka diskriminuar popullatën qoftë shumicë ose pakicë, atëherë është diskutabile dhe shumë diskutohet. Në disa shtete është marrë për shembull, si në vendet e Amerikës Latine, ku regjimi diktatorial, për shembull të Pinoches, ka bërë 30 vjet masakër në popullin e vet, i ka zhdukur civilët dhe ka qenë aq periudhë e gjatë kohore sa që vetë është lëkundur edhe puna e komisionit në atë shtet. Ne ndoshta është dashur ta cekim në fillim se kur është vendosur që të formohet komisioni rajonal, është marrë periudha kohore prej 1991 deri 2001, do të thotë prej shpërbërjes së Jugosllavisë ose prej vitit 1991 kur ka filluar në Slloveni e deri në vitin 2001 kur ka përfunduar konflikti në Maqedoni dhe kjo është marrë duke u bazuar në krimet e luftës dhe në Tribunalin e Hagës për krimet që janë proceduar atje.

Tash po e lidhi këtë me një fakt tjetër. Konsultimet e kaluara i kemi pasur me disa organizata jo qeveritare dhe ka qenë kryetarja e pensionistëve sa më kujtohet, e cila tha se na kemi një numër shumë të madh të pensionistëve të Kosovës, e unë po i shti këtu edhe dy prindërit e mi që kanë punuar 40 vjet dhe s'kanë pensione, i kanë kontributet në Serbi. Dhe e kemi një pjesë shumë të madhe të popullatës dhe ajo është shkelje direkte në mirëqenien sociale të secilit individ dhe njerëzit që kanë punuar në sistemin e kaluar i kanë kontributet 40 vjeçare apo sado që kanë – 30 vjeçare i kanë të vjedhura dhe edhe ajo është shkelje e të drejtave. Mirëpo, nëse ne veç kemi vendosur dhe nëse shkohet te periudha kohore 1991 – 2001 atëherë merren vetëm krimet e luftës.

Në forumin 4 që është mbajtur në Prishtinë në vitin e kaluar, kemi pasur një kërkesë që, për mendimin tim, ka qenë legjitim kur një person ka thënë ne po domi me i verifikuar dhe po domi me i futur në mandatin e komisionit vrasjet e ushtarëve nëpër kazernat e ushtrisë dhe ne që i kemi nga 30 – 40 vjet e mbajmë në mend. Unë e mbaj në mend shumë mirë këtë punë sepse i kam vizituar në atë kohë dhe i di nëpër fshatra kur janë ardhur në arkivole ushtarët. Edhe kjo është shkelje flagrante dhe kjo është dashur të përfshihet dhe të procesohet. Rasti tjetër, e di se hebrenjtë e Bosnjës, në anën tjetër, në konsultimet brenda territorit të Bosnjës kanë kërkuar – ne po domi me këqyr se çka u bë me komunitetin hebrej prej pas Luftës së dytë botërore e këndeje. Do të thotë, ka pasur në kontinuitet diskriminim dhe sidomos për neve këtu që kemi qenë popullatë e Kosovës, gjatë kohës prej ndoshta 74 apo edhe më herët, ju e mbani mend kohën e Rankoviçit që ka ndodhur dhe ç'ka s'ka ndodhur. Mirëpo, për arsye se është shumë i limituar mandati dhe financimi i kohëzgjatjes dhe i punës së hetuesisë, për shembull nëse ne fillojmë me i hulumtuar edhe të gjitha ato shkelje tjera që nuk hynë në këtë periudhën dhjetëvjeçare – a mendoni ju që Parlamenti ose Qeveria e Kosovës me buxhet të konsoliduar 1 miliardë a sa i ka 100 miliardë euro kishte mund me përballua atë barrë. Unë nuk besoj se kishte me mund dhe atëherë ishte dashur me kërkuar asistencë prej Komisionit Evropian, prej Shteteve të Bashkuara apo prej vendeve të zhvilluara. Dhe kur e kërkon asistencën atëherë ata veç të limitojnë pak. Këtë e dimë. Kështu që, me gjithë dëshirë, ne duhet të jemi pak edhe pragmatikë dhe objektivë, sepse e dimë që shkeljet e njeriut kanë zgjat në kontinuitet mirëpo dhuna masive, lufta, krimet kanë ndodhur sidomos në dhjetëvjeçarin e fundit dhe ajo ka qenë ndoshta fundi i të gjitha të këqijave. Pra vetëm po dua të ju them se, nëse ne, me gjithë dëshirën e madhe, e fusim në mandat... unë vetëm po e hap si debat që ta diskutojmë me ju dhe e fusim në mandat dhe po domi prej vitit 1980 krimet në Kosovë çfarë kanë qenë, ose për shembull se a ekziston evidenca e ushtarëve të vrarë për shembull në Kosovë dhe ekziston, jam shumë e sigurt, po ekziston edhe në Beograd dhe e kanë edhe njerëzit e institucioneve tona. Atëherë, hajde po e fusim. Po, mirë, atëherë hajde financojeni ju vetë ato hulumtime. Pra, janë të lidhura. Ose, hajde tash i jepni ekspertët tuaj të cilët do të hyjnë dhe hulumtojnë. Do të thotë është zinxhir i kompetencave, është zinxhir i përgjegjësive që duhet me i marrë. Nuk është bash punë dëshirë – po domi e s'po domi, por pastaj ka edhe implikime tjera.

Isa Gashi: Ju thatë se në përbërje të komisionit do të jenë edhe historianë, edhe psikiatër. Një historian nëse ia fillon prej 80-ës, ai s'është historian, është përjetues, sikur unë që e kam përjetuar. Nëse fillon prej 1912 për vuajtjet e shqiptarëve e deri në 1945 sa njeri ka hy në burg në Pejë dhe s'ka dalë, po pa dal hiq në gjyq, ai ka shkuar në Jahorinë në Zagreb, e sa tjerë e tjerë, e sa tortura i kemi pasur, e mbaj në mend të 45-ën, 47-ën, 56-ën

e rend, 63-ën e deri që u bë qysh u bë, tëra i mbaj mend. Historiani, ma merr mendja i cek të gjitha. E në qoftë se ky është përjetues, përjetues jam edhe unë. Se unë i mbaj në mend, e di çka ka hekë populli, kur i ka ardhur djali në sanduk prej ushtrie. Ne kemi pas pasur një lloj krenarie që me e dërgua djalin ushtar dhe s'e kemi konsideruar si mashkull pa e krye ushtrinë, e na kanë ardhur në sanduk, ajo për neve ka qenë një punë e madhe, një punë e rëndë, një punë që kush e ka përjetuar ai e di çfarë peshe ka. Po kur është fjala se po doni prej të 1991, ë niseni prej atëherë, por ma merr mendja se pa ia nis prej fillimit s'mund të bëni asgjë. Pa nisë prej fillimit, nëse mundeni, urdhëroni. Kam dëshirë të madhe të keni sukses, e na ndihmoni edhe ne, dhe ishalla bota u shpërblen, zoti ju shpërblen. Ju faleminderit!

Besarta Vasija: Veç një sekondë, ishte së pari ky zotëria, pastaj ju. Urdhëroni!

Junuz Gutic:

Bekim Blakaj: Faleminderit, edhe për këtë pyetje. Kështu, mandati i komisionit është i paraparë që maksimalisht, hulumtimet në terren të zgjasin 3 vjet. Mirëpo, kemi komisione që kanë pasur 800 njerëz që kanë punuar, hulumtues, që janë shpërnda, më duket në Peru saktësisht, kanë pasur ekipe mobile, me kerr janë shkua nëpër fshatra dhe atje i kanë intervistuar familjarët.

Prapë po kthehem për atë që në mëngjes fola. Ka organizata të ndryshme që kanë bë regjistrimin. Organizata ime, pothuaj se mbi 90% të rasteve i kemi bë. Komisionit i mbetet vetëm t'i verifikojë ato të dhëna edhe një herë. Prandaj, unë mendoj se për hulumtime 3 vjet janë të mjaftueshme, plus 6 muaj tjera për të shkruar raportin. Përndryshe, ju morët shembullin Sheshelin, e përmendët disa herë. Komisioni nuk ka me pas atë kompetencë me i mbajt gjykim dikujt. Do të thotë, nuk mund ta gjykojmë askënd. Vetë fjala komision rajonal për përcaktimin e fakteve për krime të luftës, do të thotë me u mbledhë të dhënat e faktet për ato krime që janë bërë. Faleminderit!

Junuz Gutic:

Besarta Vasija: Më falni, vetëm pak të ndërhyj këtu, e pastaj ia japim fjalën edhe zotërisë. Unë desha të ndërhyj këtu për atë se ky komision këtu do të hulumtoj. Edhe pse organizatat i kanë të dhënat e veta, ato nuk kanë me u marrë si të sakta pa u verifikuar dhe në raste të cilat nuk janë aty, atëherë kanë me u marrë prapë deklaratat. Ky komision nuk do të marrë asnjë deklaratë prej organizatave si të kryera dhe të mbyllura. Secili send do të verifikohet. Prandaj, kemi për shembull komisionin e Ekuadorit, e cila dy-tri herë e ka shtyrë afatin e përfundimit të komisionit. Nëse për 3 vjet nuk mbaron, atëherë ne kërkojmë do të thotë edhe 6 muaj tjera, ose edhe një vit tjetër. Nuk është kjo diçka statike e cila fare nuk mund të ndryshojë. Normalisht, duhet të mundohemi të kryhet në atë afat, po nëse jo, nëse dëmi është më i madh se sa ne që po e paramendojmë, siç ka qenë për shembull edhe në Peru ku humbjet kanë qenë shumë më të mëdha se që e kanë paramenduar, atëherë mund të shtyhet afati i saj.

Së pari zotëri Tahiri, pastaj zotëri Dauti.

Tahir Rraci: Ju faleminderit! U cekën këtu, me i marrë me i analizuar ato, ne kemi komision i cili do kah formohet tash, po domi me ngarkuar aq rënd sa që me qenë edhe qeveri e shtetit s'mund t'i zgjidh këto probleme. Çdo respekt për mixhën dhe për ata njerëz, por i kemi pasur edhe 213 a sa kanë qenë intelektualë tanë nga të cilët ende është nëpër burgje të Leskovcit i pa shlyer prej tyre. Ata dihet kush i ka marrë. Ka qenë shteti duke funksionuar. Dihen njerëzit. Çdo respekt për familjet e ushtarëve të vrarë, por ata dihet kur ia ka dorëzuar djalin ushtarë, në cilën kazermë ka qenë, e ka adresën dhe ato

janë gjëra që dihen. E t'i ndihmojmë këtij komisioni të formohet sa më shpejt dhe le të punojë në zbardhjen e njerëzve për të parën pikë – njerëzve të zhdukur. Të dinë familjarët a e ka të gjallë a të vdekur, bar eshtrat dhe varrin ta dinë. Mos ta ngarkojmë me këtë komision. Nëse ky komision arrin me kohë dhe shumë shpejt ta kryejë punën, le ta ngarkojmë me diçka tjetër. Por njëherë le të fillojë. E dyta, konflikti në Maqedoni. Unë pajtohem me juve se edhe atje ka pasur luftë, por Sllovenia pat luftë të shkurtër 2 a 3 ditë me Jugosllavinë. Kroacia pati me Serbinë, Bosnja me Serbinë, Kosova me Serbinë, Mali i Zi pak me Kroacinë atje. Maqedonia nuk ka pasur konflikt, ajo ka pasur luftë – konflikt brenda shtetit të vet. Ajo me asnjë shtet nuk ka pasur konflikt. Krejt këto janë shtete që kanë pasur konflikt ndër veti. Maqedonia e ka pasur një konflikt brenda shtetit të vet. Pse të përfshihet kjo në këtë periudhën pasi është ai shtet, ka qenë e pranuar, mendimi im është ky. Ju faleminderit!

Besarta Vasija: Po vetë fakti që edhe atje ekzistojnë ende problemet ku ndoshta qeveria edhe nuk ka vullnet me i zgjidhë ato, a duhet ne me i lënë ato me qenë të mbyllura. Edhe ajo është një pasojë e shpërbërjes. Po a duhet tash ne me lënë atë si pjesë anash. Pastaj, problemi tjetër te Sllovenët është, edhe pse ka pasur pak ditë luftë, është puna e të ashtuquajturve fshirët. Do të thotë edhe kjo është një kohë qysh kur ka filluar prej 1991 deri kënde, do të thotë nuk janë ndalë këto, do të thotë ka vazhduar, krejt kjo si tha edhe Nora është zinxhir dhe njëra me tjetrën lidhet, secila ka lidhje me tjetrën. Pse jo, pse mos me lënë anash, na kemi pasur edhe pjesëmarrës të cilët kanë thënë se duhet të përfshihet edhe Presheva, do të thotë Lugina e Preshevës e Bujanovcit dhe edhe ata duhet të përfshihen. Do të thotë, në fakt krejt këto e kanë burimin e njëjtë.

Tahir Rraci: A bën, meqë e përmendët Maqedoninë. Jo më shumë se para një jave isha në Maqedoni në një konsultim, jo të KOMRA-s por në një forum tjetër që ishin mbledhur shqiptarët dhe maqedonët e bisedonin për çështje të ndryshme dhe beso që të kishe qenë pjesë e atij diskutimi e kishe pa se është e njëjta gjë që ndodh edhe këtu në Kosovë. Shqiptarët ose maqedonasit, varësisht, kryesisht shqiptarët kanë pasur më shumë viktima atje, të gjithë janë në kërkim. Shumica prapë kërkojnë në njëfarë forme – qeveria po instalohet, por hallet e viktimave askush nuk po i zgjidh në Maqedoni. Është po thuaj i njëjti variacion duke u sjell edhe atje, kështu që në atë vazhdë, sikur që e the dhe mirë e the, atë ndarje që është shtet i brendshëm, mirëpo duke qenë se po thirret në emër të shpërbërjes së Jugosllavisë atëherë mund të merret në kontekst. Faleminderit!

Besarta Vasija: Po, është edhe rasti i shqiptarëve, bile në Pejë kanë qenë në konsultimet e kaluara, panelistë ka qenë edhe një prej familjes së viktimave të Bosnjës. Për shembull ai ka treguar se gjatë luftës në Bosnjë ka pasur shumë shqiptarë të cilët janë vra, janë zhdukur, të cilët kanë qenë shqiptarë tetovarë. Ka pasur edhe kosovarë brenda tyre por një pjesë më e madhe kanë qenë të atyre të Tetovës. Prandaj askush nuk i ka dhënë llogari askujt, as nuk dihet ku janë, as si janë vra, as pse janë vra. Do të thotë në njëfarë mënyre është konflikt dhe krejt këto lidhen njëra me tjetrën. Prandaj ne e kemi marrë do të thotë deri në vitin 2001 për mos me mbet anash asnjë viktimë, për mos me lënë anash asnjë viktimë, sepse në fakt si viktimat në Maqedoni, si viktimat në Kosovë, si viktimat në Bosnjë, si viktimat në Serbi e Kroaci të gjitha janë viktima. Nuk ka dallim te viktima. Njerëz janë. Një nënë diku shpirti i qanë për fëmijën, pa marrë parasysh çfarë nacionaliteti është. Prandaj, nuk është mirë ne të themi tash Maqedonia ka pasur brenda

shtetit të vetë. Fundi i fundit, krejt kjo ka qenë bashkë, krejt kjo ka qenë Jugosllavi dhe gjithçka ka ndodhur brenda shteteve të Jugosllavisë. Dikush tjetër, a do? Po zotëri Daut.

Daut Elshani: Ai, myslimani the, asnjë s'është këtu pa viktimë. Fakt është, të gjithë jemi me viktimë. Unë i kam 7, 3 djem, vëllain – 4, 3 të mitë – 7 edhe 3 kushërinj bëjnë 10. E kisha kërkuar prej komisioni me u marrë parasysh këto gjëra, që përsërita edhe parëz, për atë masakrën e Staradranit, kisha kërkuar shumë – shumë prej udhëheqësish me i sqarua, atë çka është dhe që i takon kujt. As mos me ia shtua as mos me ia zvogëluar. A po më kupton motër dhe vëlla, e çka duash. Por disa njerëz tash kanë bë, jo viktimë si e jotja si e imja. Jo, jo. Të tutë, si tutë, e të mitë si të mitë, sepse unë s'kam përkrahje. A po më kuptoni. Ju keni përkrahje, unë s'kam përkrahje, a më kupton. Atëherë duhet me i shikua do gjëra komisioni. Ju faleminderit që na keni thirr. Për komision jemi ditën e natën. Vetëm i këshilloj të gjithë, vetëm për të vërtetën, kujt çka i takon, çka ka bërë, çka ka, ku ka qenë, çka është kanë, qysh është kanë. Sepse të gjitha janë viktimë, janë dëshmorë. Një nëne një fëmijë prej barkut ia kanë heq, e di mirë fort, serbët. A s'është dëshmorë ai fëmija, e ajo nënë a? Po na i kemi bë do sende deri tash që s'na ka thirr askush, sa për një hu të qenit siç thonë katundarë. E ne të gjithë një thumb që e rrahim me çekiç, kanë thënë pleqtë, tërë e rrahim atë, për një maje e qet. Edhe na të gjithë jemi për ato sende me na i sqarua dhe me i qit në dritë. Aq sa i ka takuar djalit tim, e atij, sepse unë djemtë i kam pas me pushkë në dorë. Sali Lajqi komandant i ushtrisë i ka përcjell andej e këndej dhe Daut Haradinaj, Shkelzen Haradinaj – shokë të ngushtë i kanë pas. Tash unë, kur erdha i gjeta do lista, jo në rregull për trupin tim. Ju faleminderit të gjithëve burra. Ndoshta e teprua pak. Edhe juve ju falënderoj që na keni thirrur. Skam kurrëgjë më tutje dhe s'di çka me thënë.

Besarta Vasija: Pra, qëllimi i krejt kësaj dhe qëllimi i formimit të komisionit është që të zbardhet e vërteta dhe faktet. Mua po më vjen mirë kur po thoni të gjithë ju, po e përkrahni formimin e këtij komisioni. Ne pa juve nuk mund të bëjmë asgjë. Ata të cilët e përkrahin themelimin e këtij komisioni, sepse vetëm në Kosovë i kemi 151 individë dhe organizata e shoqata tjera të cilat e kanë përkrahur dhe e kanë nënshkruar këtë deklaratë, do të thotë përmes kësaj deklarate që e keni ju secili para veti, nëse dikush e ka nënshkruar këtë dhe me këtë faktikisht i bie edhe mbështetje gjithë kësaj, mund të na i lëni ne dhe përmes kësaj edhe anëtarësoheni e bëheni pjesë e këtij koalicioni dhe përmes kësaj ju tregoni se po e mbështetni këtë koalicion për themelimin e komisionit rajonal.

Ndoshta kishit pasur nevojë me ju sqaru, mund ta nënshkruani këtë edhe në emër të shoqatës, edhe në emër të individit. Nëse e nënshkruani në emër tuajin si individ, e shkruani këtu emrin tuaj dhe përfundi e shkruani vetëm emrin, ndërsa nëse e mbështetni këtë si shoqatë apo si organizatë e shkruani emrin e organizatës.

Kjo nuk do të jetë fundi këtu. Ne kemi me pas edhe konsultime tjera, në pjesë tjera të Kosovës. Kemi me pas edhe me kategori të ndryshme të njerëzve. Dhe, mua po më vjen mirë që sot në mesin tonë kemi pasur edhe përfaqësues të komunitetit boshnjak. Unë ju kisha falënderuar të gjithëve. Nëse nuk ka dikush tjetër çka të shtojë, mendoj se mund ta përfundojmë me kaq dhe ne do të ju informojmë juve për secilën ngjarje të mëtutjeshme po edhe kur kemi konsultime tjera dhe çka po ndodh me këtë.

Edhe një herë ju falënderoj në emër të krejt Koalicionit. Faleminderit edhe Vetonit që e ka organizuar kaq mirë këtë. Faleminderit të gjithëve ju që keni qenë prezentë.

Edhe një informatë të shkurtër, ju lutem! Kush ka shpenzime të udhëtimit, që i ka faturat me veti, aty në tavolinë kemi me qenë me kolegen për kompensim të shpenzimeve të rrugës. Faleminderit!